



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 2 regjistër (JR)
Datë 08.01.2019

Nr. 26 i vendimit
Datë 21.10.2019

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga:

Ardian Hajdari	Kryesues
Ina Rama	Relatore
Natasha Mulaj	Anëtare
Luan Daci	Anëtar
Sokol Çomo	Anëtar

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 21.10.2019, ditën e hënë, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Elka Ermenkova, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Ramadan Troci, prokuror pranë Prokurorisë së Përgjithshme Tiranë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 77, datë 15.11.2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Ramadan Troci.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni F i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe nenet 62, 63 e vijues të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e kërkimet e subjektit të rivlerësimit të paraqitura në ankim dhe parashtrimet e tij, i cili bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 77, datë 15.11.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin e tij në detyrë, dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes Ina Rama, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Ramadan Troci, në kohën e kryerjes së procesit të rivlerësimit nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), ka mbajtur detyrën e prokurorit pranë Prokurorisë së Përgjithshme dhe ka kandiduar për pozicionin e anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Në këto rrethana, bazuar në përcaktimet e nenit 279 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, nga Komisioni ai i është nënshtruar procedurave të rivlerësimit me përparësi. Për këtë subjekt rivlerësimi, nga Komisioni është hedhur shorti në datën 30.11.2017, në zbatim të rregullores “Për procedurat e zhvillimit të shortit” të këtij institucioni. Në funksion të shqyrtimit administrativ të çështjes, Komisioni, bazuar në përcaktimet e neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e hartuara nga institucionet: 1) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); 2) Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) dhe 3) Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshme, sipas të cilave ka rezultuar:
 - ILDKPKI, pasi ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konkluduar se:
 - a) deklarimi nuk është i saktë dhe në përputhje me ligjin;
 - b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
 - c) ka kryer fshehje të pasurisë;
 - ç) ka kryer deklarim të rremë;
 - d) nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.
 - Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, sipas parimeve e kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016, dhe ka dërguar një raport të arsyetuar, duke konkluduar mbi “Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Ramadan Troci”.
 - Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshme ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar raport të hollësishëm lidhur me vlerësimin e tyre.
2. Më datë 15.10.2018, trupi gjykues i Komisionit vendosi të përfundojë hetimin paraprak për subjektin e rivlerësimit Ramadan Troci, bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit: në kriterin e kontrollit të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, dhe të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet paraprake të këtij hetimi. Në zbatim të parashikimeve të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të dhënë argumente dhe prova në lidhje me konstatimet e bëra gjatë hetimit administrativ.
3. Më datë 29.10.2018, subjekti i rivlerësimit ka dërguar pranë Komisionit shpjegimet e tij mbi rezultatet paraprake të hetimit të kryer nga ky institucion. Nga Komisioni, më datë 09.11.2018, është zhvilluar seanca dëgjimore publike për procesin e rivlerësimit të subjektit Ramadan Troci, tek e cila subjekti ka qenë i pranishëm. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni shpalli për subjektin e rivlerësimit Ramadan Troci vendimin nr. 77, datë 15.11. 2018.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

4. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me vendimin nr. 77, datë 15.11.2018, ka vendosur: *Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Ramadan Troci, me funksion prokuror pranë Prokurorisë së Përgjithshme Tiranë.*

Ky vendim është marrë bazuar në nenin 58, pika 1, germa “c”, si dhe në nenin 61, pikat 3, 4 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

5. Komisioni, vendimin nr. 77, datë 15.11.2018, për subjektin e rivlerësimit Ramadan Troci, e ka marrë bazuar në vlerësimin e tri kritereve, përkatësisht kriterin e kontrollit të pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale, pasi nga hetimi i kryer është arritur në përfundimet e mëposhtme.

Në lidhje me kontrollin e pasurisë:

- 1) *subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht pagesën e këstit të parë, për prenotimin e apartamentit deri në vitin 2011;*
- 2) *subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht pagesën e bërë për blerjen e automjetit në vitin 2008;*
- 3) *subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin e depozitës prej 2.500.000 lekësh, në fund të vitit 2016;*
- 4) *subjekti ka fshehur pasurinë, ndërtimin pa leje me sipërfaqe 32 m², në truall të zënë me sipërfaqe 450 m², në {***}, Tiranë, ndërtim i cili sipas përgjigjes së ALUIZNI-t, rezulton me kërkesë vetëdeklarimi nga ana e tij më datë 07.11.2006;*
- 5) *subjekti në vazhdimësi nuk ka deklaruar gjendjet e llogarive bankare, nuk ka deklaruar saktë shtesat e depozitës në emër të bashkëshortes së tij, si edhe ka kryer deklarime të pasakta lidhur me të ardhurat e përfituara;*
- 6) *bazuar në indicie dhe të dhëna të rëndësishme, Komisioni krijoi bindjen se subjekti është pronar de facto i disa pasurive të tjera, të listuara më sipër, të cilat janë regjistruar në emër të të afërmeve dhe familjarëve të tij;*
- 7) *Vëllai i subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e personit tjetër të lidhur, nuk justifikon me burime të ligjshme pasuritë e tij.*

Në përfundim të hetimit administrativ lidhur me kontrollin e pasurisë, Komisioni ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit Ramadan Troci:

- *nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm;*
- *ka fshehur pasurinë.*

6. Në lidhje me kontrollin e figurës, Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Ramadan Troci ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

7. Në lidhje me kontrollin e aftësive profesionale, Komisioni pas hetimit të kryer për disa çështje të hetuara nga subjekti i rivlerësimit gjatë punës së tij si prokuror pranë Prokurorisë së Gjykatës së

Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Dibër e Bulqizë¹, çmoi se pozita e subjektit të rivlerësimit duhet të konsiderohej në vështrim të nenit E, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i cili parashikon: [...] 5. Në rast se subjekti i rivlerësimit kryen veprime për të penguar ose vështirësuar vlerësimin e tij, ose rezulton se ka njohuri, aftësi, gjykim, qëndrime, ose një model pune aq të dobët saqë rrezikon ose cenon të drejtat e qytetarëve, ai konsiderohet i papërshtatshëm për të ushtruar funksionin. Në këtë rast zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën.

8. Në përfundim të hetimit nga Komisioni për subjektin e rivlerësimit, u konstatua se ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë dhe rezulton i papërshtatshëm nga vlerësimi i aftësive profesionale. Komisioni gjithashtu arriti në konkluzionin se edhe nga vlerësimi tërësor në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit rezulton se ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit.

III. Shkaqet e ankimit

9. Subjekti i rivlerësimit Ramadan Troci, më datë 31.12.2018, ka paraqitur ankimin e tij ndaj vendimit nr. 77, datë 15.11.2018, të Komisionit, ankim i cili është pranuar nga trupi gjykues i Komisionit, me vendimin nr. 4, datë 04.01.2019.
10. Shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit Ramadan Troci kundër vendimit nr. 77, datë 15.11.2018, të Komisionit, në mënyrë të përmbledhur janë si më poshtë
 - A. Lidhur me procesin e rregullt ligjor
11. Subjekti i rivlerësimit pretendon cenim të procesit të rregullt ligjor nga Komisioni, duke ngritur pretendimin se:
 - Gjatë procesit të tij të rivlerësimit nga Komisioni është shkelur parimi i kontradiktorialitetit, barazisë së armëve dhe prezumimit të pafajësisë.
 - Në gjykimin e kryer nga Komisioni është cenuar e drejta e subjektit për një proces të drejtë e të paanshëm, pasi vlerësimi i provave duhej bërë në respektim të parimit të objektivitetit dhe proporcionalitetit.
 - Sjellja e trupit gjykues të Komisionit nuk përmbush standardin e gjyqimit të çështjes nga një trup gjykues i pavarur, pasi ai njëkohësisht ka kompetencë të kryejë hetime, të bëjë vlerësim të provave dhe të marrë vendim.
 - Komisioni nuk është shprehur nëse pasuria e subjektit të rivlerësimit është sa dyfishi i pasurisë së ligjshme si dhe nuk ka arritur të provojë që mungesa e likuiditeteve apo pasaktësive gjatë deklarimeve në vite të ketë sjellë një akumulim të pasurisë më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme.

¹ Subjekti i rivlerësimit Ramadan Troci, në periudhën 16.03.2001 - 31.08.2007, ka ushtruar funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Bulqizë; në periudhën 01.09.2007 - 16.04.2012, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër.

B. Lidhur me kriterin e kontrollit të pasurisë

12. Moskonsiderimi nga Komisioni si burim të ardhurash në analizën financiare të shumës prej 700.000 lekësh për blerjen e apartamentit është i padrejtë, pasi kjo vlerë është krijuar me burime të ligjshme nga puna e bashkëshortes së tij. Shpenzimet e jetesës të aplikuara nga KPK në analizën financiare janë më të larta se ato të aplikuara ndër vite në analizën nga ILDKPKI, si dhe nga të dhënat zyrtare të shpenzimeve të jetesës së INSTAT.
13. Analiza financiare vit pas viti e kryer nga Komisioni për periudhën 2003-2012 është e pasaktë, krahasuar kjo me analizën financiare të paraqitur nga vetë subjekti për secilin nga këto vite.
14. Mosdeklarimi i objektit me sipërfaqe prej 32 m² në truall të zënë prej 450 m² në {***} në deklaratat vjetore periodike të vitit 2006 e në vijim dhe në deklaratën *vetting* nuk përbën fshehje të pasurisë, pasi kjo pasuri nuk është faktikisht në pronësi të subjektit, por të babait të tij, z. D. T..
15. Për automjetin “Volkswagen Tiguan”, me targa {***}, subjekti parashtron/pretendon se Komisioni nuk ka arritur të provojë tej çdo dyshimi të arsyeshëm qëllimin e subjektit të rivlerësimit në sjelljen si pronar mjeti, si dhe nuk ka marrë në vlerësim të drejtë shpjegimet e dhëna prej tij lidhur me këtë çështje.
16. Trajtimi si person tjetër i lidhur i z. N. T., vëllait të subjektit të rivlerësimit, është bërë në kundërshtim me faktet që kanë rezultuar nga hetimi dhe ligji, po ashtu edhe analiza financiare e kryer për të. Në vijim, është i pabazuar në fakte e në ligj konkluzioni i Komisionit se pasuritë e regjistruara në emër të vëllait të tij janë pasuri të fshehura të subjektit.
17. Qëndrimi i Komisionit për pasuritë e regjistruara në emër të shtetasit R. M., kunati i subjektit, të cilat i konsideron si pasuri të fshehura të subjektit, është një qëndrim i njëanshëm, i arsyetuar mbi hamendje dhe i pambështetur në prova.
18. Qëndrimi i mbajtur nga Komisioni për pasurinë apartament, të marrë me qira prej tij nga shtetasi A. Sh., të cilën e konsideron si pasuri të fshehur prej subjektit të rivlerësimit, është një qëndrim i pabazuar, pasi ai është i mbështetur mbi bazën e indicieve dhe jo të provave.

C. Lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

19. Në çështjet e analizuar nga Komisioni, që kanë të bëjnë me shkeljen e rregullave të mbrojtjes në punë, vendimet e mosfillimit apo të pushimit të procedimeve penale për to, janë të konfirmuara nga eprorët dhe se këto vendime kanë qenë objekt kontrolli nga Prokuroria e Përgjithshme, e cila nuk ka dhënë asnjë masë disiplinore për subjektin në përfundim të kontrollit.
20. Nga Komisioni nuk u gjet asnjë rast/çështje hetimi i të cilit të ketë pasur zvarritje, të cilat, sipas kërkesave të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (në vijim “GjEDNJ”), e bëjnë joefektiv.
21. Në çështjet që lidhen me veprën penale të “shkeljes së rregullave të mbrojtjes në punë”, ekspertët janë caktuar në përputhje me parashikimet e dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, duke zgjedhur si të tillë individë që kanë njohuri në fushën përkatëse.
22. Prej Komisionit kontrolli dhe vlerësimi i aftësive profesionale është bërë duke u referuar vetëm në ankesat anonime dhe pa kryer një hetim të thelluar mbi aftësitë profesionale, etike dhe organizative të subjektit në tërësinë e tyre.

Ç. Lidhur me vlerësimin e bërë nga Komisioni për cenimin e besimit të publikut

23. Subjekti pretendon se aplikimi i kriterit të cenimit të besimit të publikut është i pabazuar, pasi në asnjë rast Komisioni nuk ka arritur të provojë se ai ka pasuri më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme, ka probleme me figurën, ka fshehur pasuri apo ka bërë deklaram të pasaktë të saj, si dhe nuk rezulton i papërshtatshëm nga vlerësimi i aftësive profesionale.
24. Në mbështetje të shkaqeve të ankimit dhe të pretendimeve të tij, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur një sërë provash të reja, për të cilat ai ka kërkuar të shqyrtohen prej trupit gjykues të Kolegjit (në vijim “Kolegji”), pasi sipas tij ato provojnë pretendimet e tij rreth pabazueshmërisë së vendimit të Komisionit.
25. Kolegji mori në shqyrtim pretendimet e subjektit të rivlerësimit, duke analizuar provat e reja të paraqitura në pikëpamje të formës dhe përmbajtjes së pretenduar, në raport me parashikimet ligjore që rregullojnë këtë moment procedural, dhe konstatoi sa më poshtë.
26. Në drejtim të momentit procedural të paraqitjes së tyre, një pjesë e provave të paraqitura janë të njëjta me ato të dërguara nga subjekti i rivlerësimit pranë Komisionit së bashku me shpjegimet e tij për rezultatet paraprake të hetimit. Nga provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit së bashku me ankimin, Kolegji, pasi i shqyrtoi ato, konstatoi se janë akte të reja të cilat nuk gjenden të administruara në fashikullin e gjykimit, dokumentet si vijojnë:
 - 1) Deklaratë noteriale e subjektit Ramadan Troci, me nr. rep., {***} dhe nr. kol {***}, datë 18.12.2018, në të cilën deklaroi para noterit se nuk ka pasur dijeni për aplikimin e bërë pranë ALUIZNI-t për legalizimin e objektit 32 m² në {***} (vetëdeklarimi nr. {***}, datë 07.11.2006) në emër të tij, duke deklaruar se: [...] *Me këtë akt deklaroj se nuk kam pasur dijeni për këtë vetëdeklarim të babait tim dhe se nuk kam dhe nuk do të kem pretendime për pronësi dhe bashkëpronësi të pasurisë së cituar në vetëdeklarim dhe se jam dakord që leja e legalizimit të dalë vetëm në emër të babit tim, D.T.. E bëj këtë deklaram për ta depozituar pranë ALUIZNI-t në mënyrë që leja e legalizimit të dalë vetëm në emrin e tij pasi unë nuk disponoj truall, nuk kam aplikuar dhe nuk kam investuar për ndërtimin e këtij objekti.*
 - 2) Kërkesë e datës 18.12.2018 e subjektit Ramadan Troci, drejtuar degës së ALUIZNI-t Kamëz, me objekt “Kërkoj të ndryshohet emri i praktikës së legalizimit”.
 - 3) Shkresë nr. {***} prot; datë 19.12.2018, me objekt “Kthim përgjigjeje” nga ALUIZNI, dega Kamëz, drejtuar z. Ramadan Troci, nëpërmjet së cilës e bëjnë me dije se kërkesa e tij për ndryshim të emrit të praktikës së legalizimit për objektin 32 m² në Paskuqan i është përcjellë për veprim (ndryshim të dhënash në sistemin elektronik) Drejtorisë së Përgjithshme të ALUIZNI-t.
 - 4) Shkresa nr. {***} prot., datë 18.12.2018, e degës së ALUIZNI-t Kamëz, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të ALUIZNI-t, me objekt “Kërkohet ndryshim i të dhënave në regjistrin elektronik për subjektet sipas tabelës bashkëlidhur” dhe korrespondenca vijuese e ALUIZNI-t.
 - 5) Deklaratë noteriale nr. {***} rep. dhe nr. {***} kol., datë 24.12.2018, e bërë nga shtetasi P. S..
 - 6) Deklaratë noteriale nr. {***} rep. dhe nr. {***} kol., datë 24.12.2018, e bërë nga aksionerët e “{***}” ShPK, A. Sh., M. Sh. dhe G. Sh..
 - 7) Ekstrakti i QKR-së për subjektin “{***}” ShPK, datë 24.12.2018.

- 8) Shkresë e Prokurorisë Dibër e datës 8.12.2018, ku jepen të dhëna për vendime të prokurorëve të ndryshëm në lidhje me procedimet penale që i përkasin veprës penale të parashikuar nga neni 289 i Kodit Penal.
- 9) Shkresë nr. {***} prot., datë 24.12.2018, lëshuar nga DSIK-ja.
27. Subjekti i rivlerësimit pas paraqitjes së ankimit me parashtrimet e tij para seancës gjyqësore që do të zhvillohej në Kolegj, ka paraqitur bashkëlidhur aktet si vijojnë:
- 1) Deklaratë noteriale e datës 01.02.2019, e nënshkruar nga z. Ramadan Troci dhe shtetasi A. Sh. për afatin e përdorimit të apartamentit ku banon aktualisht subjekti i rivlerësimit, pranë {***}.
 - 2) Leja e legalizimit e datës 21.03.2019 për objektin 33,6 m² në {***}, dalë në emër të babait të subjektit, z. D. T..
 - 3) Fletë nga regjistri i gjendjes civile ku gjenden të regjistruar shtetas me emër A. H., emër nën të cilin është depozituar denoncimi kundër subjektit të rivlerësimit.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

I) Juridiksioni i Kolegjit

28. Në zbatim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) të bëjë shqyrtimin e ankimeve të subjekteve të rivlerësimit kundër vendimeve të Komisionit lidhur me rivlerësimin e tyre, të parashikuara nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Ramadan Troci, me detyrë prokuror pranë Prokurorisë së Përgjithshme Tiranë, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

II) Legjitimimi i ankuesit

29. Ankuesi legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, nenit F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis* pasi ankimi është depozituar nga subjekti i rivlerësimit pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

III) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

30. Në zbatim të nenit 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, dhe neneve 49 e 55 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”), shqyrtimi i ankimit të subjektit të rivlerësimit ndaj vendimit nr. 77, datë 15.11.2018, u mor në shqyrtim në dhomë këshillimi.

31. Trupi gjykues i Kolegjit shqyrtoi fillimisht kërkesën e subjektit të rivlerësimit për marrjen me cilësinë e provave të reja të akteve që ai i ka bashkangjitur ankimit dhe të akteve të reja të depozituara në Kolegj me parashtrimet, pas depozitimit të ankimit.

Analiza e pranueshmërisë për shqyrtim ose jo të këtyre provave, lidhet me zbatimin e normave ligjore që rregullojnë situatën në fjalë. Kolegji e mbështeti vendimin e tij në këtë rast në nenin 47 të ligjit nr. 49/2012, sipas të cilit: *Në ankim nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të kërkohen prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se pa fajin e tij nuk ka mundur t'i paraqesë këto fakte ose t'i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në gjykatën administrative të shkallës së parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj*, dispozitë kjo e detyrueshme për zbatim në referim të nenit 65 pika 1 të ligjit nr. 84/2016. Gjithashtu, analiza e këtij pretendimi u mbështet edhe në nenin 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, e cila parashikon:

Kërkesa për marrjen e një prove refuzohet nga Komisioni ose Kolegji i Apelit, nëse nuk lejohet nga ligji ose në rastet kur:

- a) marrja e provës duket se është e panevojshme;*
- b) fakti që kërkohet të provohet, është i parëndësishëm për vendimmarrjen ose mund të rezultojë i provuar gjatë gjykimit; [...]*
- d) pretendohet të provohet një fakt në favor të subjektit të rivlerësimit, i cili edhe po të konsiderohet i vërtetë, nuk ndikon në marrjen e vendimit.*

32. Në verifikim të këtyre parashikimeve ligjore, në rastin konkret Kolegji çmoi se provat e paraqitura prej subjektit bashkëlidhur ankimit, nuk mbështeteshin mbi fakte që provonin mospasjen mundësi të paraqitjes së tyre që në fazën e hetimit administrativ, siç kërkon zbatimi i nenit 47 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”), por edhe sikur të ishin në përputhje me kriteret e kësaj dispozite, ato u konsideruan prej Kolegjit si të panevojshme në kuptim të nenit 49, pika 6, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.
33. Për sa u përket provave të paraqitura prej subjektit pas paraqitjes së ankimit (me parashtrimet para seancës gjyqësore), Kolegji arsyeton se së pari ato nuk plotësojnë kërkesat e parashikuara prej neneve 47 dhe 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, në interpretim të të cilave diskutimi mbi marrjen ose jo të një prove të re do të bëhet mbi provat që i bashkëlidhen ankimit dhe jo mbi prova të tjera të paraqitura tej këtij afati procedural, për të cilat plotësohen edhe kushtet e tjera të kësaj dispozite. Fakti që këto prova nuk janë paraqitur bashkë me ankimin, i përjashton ato nga analiza e mëtejshme në drejtim të vlerës së tyre, për sa i takon zgjidhjes së çështjes. Pavarësisht defektit që lidhet me mosparaqitjen në kohë të tyre si shkak të mospranueshmërisë së tyre për shqyrtim, Kolegji konstaton se në një vlerësim tërësor të çështjes në raport me informacionin që përcjellin ato, edhe këto akte nuk do të arrinin të ndikonin në zgjidhjen e çështjes.
34. Për të gjitha arsyet që u renditën më lart, Kolegji vendosi të mos pranojë marrjen në shqyrtim të akteve të paraqitura prej subjektit të rivlerësimit, siç u përkrahua më sipër dhe, duke qenë se as Kolegji vetë nuk konstatoi ekzistencën e ndonjë prej kushteve të parashikuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2016, i cili parashikon rastet se kur një gjykim administrativ në Gjykatën e Apelit zhvillohet në seancë gjyqësore publike, vendosi ta shqyrtojë çështjen në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, sipas parashikimit të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012.

B. Mbi shqyrtimin e shkaqeve të ankimit

I. Shkaqe që lidhen me procesin e rregullt ligjor

35. Në lidhje me shkakun ankimit sipas të cilit gjatë procesit të tij të rivlerësimit nga Komisioni është shkelur parimi i kontradiktorialitetit, barazisë së armëve dhe prezumimit të pafajësisë, Kolegji konstaton se subjekti ka lidhur shkeljen e këtyre parimeve me faktin se Komisioni nuk i ka nënshtruar debatit në seancë dëgjimore publike provat e paraqitura prej tij, duke pretenduar se në respektim të parimit të kontradiktorialitetit dhe barazisë së armëve, secilës palë duhet t'i ofrohen mundësi të arsyeshme për të paraqitur pretendime mbi çështjen, kjo me qëllim për të mos qenë në disavantazh me palën tjetër. Gjithashtu subjekti pretendon se Komisioni, duke i refuzuar provat e paraqitura prej tij për të cilat ka marrë vendim pranimi, ka faktuar shkeljen e parimit të prezumimit të pafajësisë.
36. Lidhur me këto pretendime të subjektit, referuar akteve të administruara në fashikull, konstatohet se Komisioni më datë 15.10.2018 ka njoftuar subjektin se, në zbatim të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe të nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, i kalon barrën e provës për sa rezulton nga hetimi administrativ i kryer; gjithashtu e bën me dije se për të ushtruar të drejtën e mbrojtjes ka të drejtë të paraqesë prova apo të thërrasë dëshmitarë dhe se afati brenda të cilit ai duhet të njihet me dosjen dhe të paraqesë prova e shpjegime për rezultatet e hetimit është 15 ditë nga dita e marrjes njoftim.
37. Më datë 02.11.2018, Komisioni, pasi ka kryer një vlerësim të kërkesës së subjektit për marrjen e provave të reja dhe thirrjen e dëshmitarëve, është shprehur me vendim për refuzimin pjesërisht të kërkesës së subjektit për marrjen e provave të reja për thirrjen dhe pyetjen e disa dëshmitarëve. Komisioni ka argumentuar se refuzimi për marrjen e një pjese të provave të reja, të sjella me shpjegimet nga subjekti, është bërë bazuar në përcaktimin e nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, duke shpjeguar se trupi gjykues vendimmarrjen e tij e bazon mbi dokumente nga burime të njohura dhe në prova të besueshme dhe nuk ka konsideruar të tilla disa nga provat e paraqitura prej subjektit, si edhe ka refuzuar thirrjen e dëshmitarëve me arsyetimin se fakti që kërkohej të provohej nëpërmjet dëshmisë së tyre, ishte i parëndësishëm/panevojshëm për vendimmarrjen e Komisionit.
38. Lidhur me pretendimet e subjektit se Komisioni ka shkelur parimin e kontradiktorialitetit, barazisë së armëve dhe prezumimit të pafajësisë, në analizë të akteve të administruara në fashikull, të cituara më sipër, rezulton që Komisioni gjatë kryerjes së hetimit administrativ ka pasur komunikim të vazhdueshëm me subjektin, gjithashtu në zbatim të parashikimeve ligjore të nenit 4, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 dhe nenit 45 të ligjit nr. 44/2015 Kodi i Procedurave Administrative, si dhe të rregullores së tij “Për hapat proceduralë të unifikuar”, të miratuar më datë 12.02.2018, subjektit i janë bërë me dije rezultatet paraprake të hetimit, i është vënë në dispozicion me qëllim ushtrimin e mbrojtjes efektive dhe të plotë e gjithë dosja hetimore e krijuar dhe i është lënë një afat i arsyeshëm për paraqitjen e shpjegimeve, prapësimeve dhe provave. Në korrespondencën e tij Komisioni² konstatohet se i bën qartësisht me dije subjektit të drejtat që gëzon në lidhje me deklarin e konfliktit të interesit, të drejtën për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarëve, si dhe afatin brenda të cilit mund të ushtroj këto të drejta në zbatim të parimit të barazisë së armëve.
39. Lidhur me pretendimin e subjektit se provat e paraqitura prej tij nuk iu nënshtruan parimit të debatit gjyqësor, Kolegji vlerëson të sjellë në vëmendje faktin se procesi i zhvilluar nga Komisioni ka kryesisht tiparet e një procesi administrativ, i cili kryhet në harmoni me parashikimet e neneve 77

² Shkresa e Komisionit e datës 15.11.2018.

dhe 81 të ligjit nr. 44/2015 Kodi i Procedurave Administrative (në vijim “K.Pr.Administrative”) lidhur me hetimin dhe vlerësimin e provave të cilat rezultojnë se janë zbatuar drejt nga Komisioni në rastin konkret.

40. Në zbatim të këtyre dispozitave të K.Pr.Administrative, Komisioni ka marrë vendimin e përshkruar më lart. Nga kjo vendimmarrje e trupit gjykues, e realizuar pas diskutimeve të kryera për çdo provë të sjellë nga subjekti, sipas parashikimit të nenit 81 K.Pr.Administrative, rezulton se nuk jeni para kushteve të pretenduara prej tij për mosanalizim të provave të sjella, por para një vendimmarrjeje që nuk plotëson pritshmërinë e subjektit, por që nuk e bën inekzistent procesin e shqyrtimit dhe të vlerësimit të provave, siç ai pretendon në ankim.
41. Për më tepër, referuar dispozitave të K.Pr.Administrative, i cili aplikohet sipas parashikimit të pikës 6 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, vlerësimi i provave të paraqitura nuk kërkohet domosdoshmërisht të bëhet në kushtet e një debati në seancë dëgjimore publike. Neni 55 i ligjit nr. 84/2016 dhe neni 87 i K.Pr.Administrative parashikon detyrimin për të dëgjuar palën para marrjes së vendimit përfundimtar, gjë e cila është zbatuar nga Komisioni me zhvillimin e seancës dëgjimore publike.
42. Gjithashtu, nga procesverbali i seancës dëgjimore, rezulton se subjekti ka prezantuar fjalën e tij, përgjatë së cilës ka shpjeguar gjatë vlerësimin e tij për të gjitha rezultatet e hetimit paraprak dhe më pas i është nënshtruar edhe procesit të një sërë pyetjesh nga trupi gjykues, duke ezauruar çdo mundësi të parashikuar nga ligji për të garantuar të drejtën e tij për t’u dëgjuar e mbrojtur.
43. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për shkelje nga Komisioni të parimit të prezumimit të pafajësisë, pasi janë refuzuar provat e paraqitura prej tij, Kolegji vlerëson se në këtë proces, në ndryshim me gjykimet e penale ku një ndër aspektet e parimit të prezumimit të pafajësisë që duhet zbatuar është *in dubio pro reo*, pra çdo dyshim shkon në favor të të pandehurit dhe barra e provës bie kryesisht mbi organin e akuzës, në procesin e rivlerësimit kemi një situatë tjetër në të cilën dominon parimi i vendosur prej nenit Ç, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, sipas së cilës: *Barra e provës i kalon subjektit të rivlerësimit vetëm për këtë proces, duke përjashtuar çdo proces tjetër, në veçanti procesin penal*, parim i cili është zbërthyer më tej në parashikimet e ligjit nr. 84/2016, respektivisht nenet 45 dhe 52 të tij. Pretendimi i subjektit për refuzimin nga Komisioni të disa provave të sjella prej tij, lidhet me mënyrën se si janë vlerësuar e interpretuar këto prova, e cila vlerësohet se ka qenë në diskrecion të tagrave të trupit gjykues të Komisionit dhe, si e tillë, nuk afekton rregullsinë e procesit të rivlerësimit të tij.
44. Në konkluzion, për këtë shkak ankimi, Kolegji vlerëson se ai gjendet i paargumentuar dhe i pabazuar.
45. Lidhur me shkakun e ankimit, sipas të cilit subjekti ka pretenduar se përgjatë hetimit administrativ është cenuar e drejta e subjektit për një proces të drejtë, të paanshëm, pasi vlerësimi i provave duhej bërë në respektim të parimit të objektivitetit dhe proporcionalitetit, Kolegji çmon se pretendimi i subjektit nuk gjen mbështetje në situatën faktike e ligjore mbi të cilën ka vendosur Komisioni.
46. Ky pretendim i subjektit, i cili adresohet posaçërisht mbi peshën e analizës financiare të kryer nga Komisioni, konstatohet se abstragon peshën e shkeljeve të tjera të ligjit mbi të cilat Komisioni ka mbështetur vendimmarrjen e tij e që lidhen jo vetëm me gjetjet që kanë rezultuar nga analiza financiare e subjektit, por edhe nga shkeljet e konstatuara në kriterin profesional e në vlerësimin tërësor të tri kriterëve. Nga dispozitat ligjore të parashikuara nga Kushtetuta, por edhe nga ligji nr. 84/2016, vërehet se ato i referohen aplikimit të parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit për zgjidhjen e çështjes në tërësi, duke synuar që në rastet objekt vlerësimi në kuadër të rivlerësimit të

subjekteve të këtij ligji, masa disiplinore e dhënë të jetë në përpjesëtim të drejtë me shkeljet e konstatuara. Në rastin e procesit të rivlerësimit, aplikimi i parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit nga organet e rivlerësimit i çon këto organe drejt dhënies së një mase disiplinore – e cila nxjerr subjektet jashtë sistemit të drejtësisë – vetëm bazuar në standarde objektive, duke u siguruar që masa e dhënë të jetë e nevojshme për të përmbushur qëllimin e ligjit³, si dhe duke vlerësuar që masa e dhënë të jetë në proporcion me shkeljet e konstatuara.

47. Në analizë të vendimit të Komisionit, konstatohet lehtësisht se masa disiplinore është dhënë bazuar në nenin 61 të ligjit nr. 84/2016, pikat 3, 4 dhe 5 të tij, fakt i cili demonstroi sipas vlerësimit të Kolegjit se nuk ndodhemi në kushtet kur mund të konsiderojmë për aplikim parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, pasi subjekti në tërësinë e procesit të tij të rivlerësimit, ka dështuar në disa aspekte, si: kontrolli i pasurisë (*ku rezulton se ka bërë deklaram të pamjaftueshëm dhe fshehje pasurie*), kontrolli i aftësive profesionale (*ku ka rezultuar me një nivel të ulët të aftësive profesionale*) dhe në vlerësimin tërësor të tij rezultoi se ka cenuar besimin e publikut.
48. Në konkluzion të sa më sipër, Kolegji e gjen pretendimin e subjektit për cenim të parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit nga ana e Komisionit si të pabazuar dhe të paargumentuar.
49. Lidhur me shkakun e ankimit, sipas të cilit kompetencat e Komisionit në procesin e rivlerësimit nuk përmbushin standardin e gjykimit të çështjes nga një trupë e pavarur, pasi ajo njëkohësisht ka kompetencë të kryejë hetime, të bëjë vlerësim të provave dhe të marrë vendim, Kolegji mban të njëjtin qëndrim të cilin e ka konsoliduar tashmë në praktikën e tij gjyqësore⁴, duke konfirmuar edhe një herë qëndrimin se:

Kompetenca e Komisionit për të kryer hetimin dhe për të dhënë vendimin është në përputhje me natyrën e procesit të rivlerësimit, si një proces i nisur kryesisht dhe në përputhje me kompetencën që atij ia njeh Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016. Ushtrimi i këtyre kompetencave nga një organ i vetëm është pranuar edhe nga Komisioni i Venecias, i cili në Opinionin CDL-AD (2016)036 për ligjin nr. 84/2016 është shprehur: *Duhet të mbahet parasysh edhe fakti se neni 4, paragrafi 4 i Aneksit të Kushtetutës i jep shprehimisht Komisionit të Pavarur dhe Kolegjit të Apelimit kompetencë të gjera për t'i investiguar dhe verifikuar vetë çështjet. Sipas paragrafit 3 të po të njëjtit nen, organet zyrtare duhet të bashkëpunojnë dhe të jenë në dispozicion informacionin e kërkuar nga Komisioni i Pavarur dhe Kolegji i Apelimit, duke siguruar akses të drejtpërdrejtë në databasën e tyre. Po ashtu, neni 45 i Ligjit të Vettingut i lejon anëtarët e Komisionit të Pavarur dhe të Kolegjit të Apelimit të hetojnë në mënyrë të pavarur për të gjitha rrethanat e çështjes. Neni 57(4) parashtron parimin se në procesin vendimmarrës të Komisionit të Pavarur, përfundimet nxirren nga trupi gjykues.*

Në konkluzion, Kolegji e gjen edhe këtë shkak ankimi të pabazuar në ligj.

50. Lidhur me shkakun e ankimit, sipas të cilit subjekti pretendon se nga Komisioni në asnjë rast nuk u provua se ai ka më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme, Kolegji konstaton se referuar të gjithë arsyetimit dhe përmbajtjes së vendimit të Komisionit nr. 77, datë 15.11.2018, për subjektin e rivlerësimit në asnjë rast nuk rezultoi që në pjesën arsyetuese e as në pjesën urdhëruese të jenë mbajtur qëndrime lidhur me pasjen e dyfishit të pasurisë së ligjshme, sipas parashikimit të nenit 61, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Për më tepër, referuar dispozitivit të këtij vendimi, rezultoi që masa

³ Referuar parashikimeve të nenit 1 të ligjit nr. 84/2016, qëllim i këtij ligji është rikthimi i besimit të publikut te sistemi i drejtësisë.

⁴ Shih vendime të Kolegjit ku trajtohet kjo çështje.

disiplinore e shkarkimit nga detyra për subjektin e rivlerësimit të jetë dhënë bazuar në parashikimet e nenit 61 pikat 3, 4 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016.

51. Në këto kushte, duke qenë se konstatohet që përcaktimi e nenit 61, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ku parashikohet dhënia e masës së shkarkimit nga detyra për rastet kur rezulton se subjekti ka më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme, nuk është aplikuar në këtë rast nga Komisioni, pretendimi i subjektit për zbatim të gabuar të kësaj dispozite, konsiderohet i paarsyeshëm dhe i padrejtë nga Kolegji.

II. Shkaqe që lidhen me kontrollin e pasurisë

52. Nga shqyrtimi në tërësi i ankimit të subjektit të rivlerësimit Ramadan Troci, konstatohet se shkaqet e tij të ankimit që lidhen me procesin e rregullt u referohen kryesisht qëndrimeve të mbajtura nga Komisioni gjatë hetimit administrativ të kryer prej tij për refuzimin e marrjes në cilësinë e provës të akteve të caktuara apo të dëshmimeve nga persona të caktuar, të kërkuar prej subjektit të rivlerësimit.
53. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar në të gjitha konkluzionet qëndrimin që ka mbajtur Komisioni pas kontrollit të pasurisë dhe verifikimit të deklarimeve të tij, duke pretenduar se vendimi i Komisionit, për sa u përket konkluzioneve lidhur me kriterin e kontrollit të pasurisë, është i padrejtë për shkaqet e mëposhtme.
54. Në lidhje me pasurinë apartament që ndodhet në kompleksin “{***}”, {***}, Tiranë, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*⁵ se ai ka në pronësi një apartament, me sipërfaqe bruto 108,7 m², sipërfaqe neto 94,4 m², ndodhur në rr. “{***}” Kompleksi “{***}”, shk. {***}, ap. {***}, {***}, Tiranë, me nr. {***}; vlera e deklaruar: 5.494.080 lekë; pjesa në përqindje: 50%; burimi i krijimit: kursimet nga paga e subjektit dhe e bashkëshortes nga vitet 2004 deri 2011, në shumën 2.914.080 lekë dhe kredi për blerje apartamenti të disbursuar, më datë 07.06.2011, në shumën 2.580.000 lekë.
55. Në lidhje me këtë pasuri, Komisioni ka konkluduar në përfundim të hetimit administrativ se subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht pagesën e këstit të parë prej 20.000 eurosh, për prenotimin e apartamentit deri në vitin 2011.

Analiza financiare e kryer në Komision ka analizuar të dhënat që i përkasin periudhës 2004 deri në muajin mars 2011, duke qenë se kontrata e porosisë së lidhur mes subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë “{***}” ShPK mban datën 04.03.2011. Në këtë analizë është mbajtur gjithashtu jashtë trajtimit të të dhënave analiza financiare për vitin 2003, duke qenë se subjekti nuk ka deklaruar ndonjë kursim të akumuluar në këtë vit e të përdorur si burim për blerjen e apartamentit. Në vlerësim të analizës financiare të kryer për këtë periudhë, duke analizuar të gjitha të dhënat e paraqitura prej subjektit të rivlerësimit në lidhje me të ardhurat e tij dhe të personave të lidhur, shpenzimet e jetesës për familjen e tij, pasuritë si likuiditet të kursyera në gjendje *cash* dhe në llogari bankare, shpenzimet e udhëtimeve dhe çdo shpenzim tjetër të kryer e të deklaruar apo dokumentuar prej subjektit, Komisioni ka arritur në konkluzionin se subjekti ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme për ta paguar këtë këst në datën 04.03.2011, në masën prej 754.238 lekësh.

Kundër këtij konkluzioni dhe në lidhje me disa të dhëna të analizës financiare, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar kundërshtitë e tij nëpërmjet shkaqeve të ankimit të paraqitura si më poshtë.

⁵ Deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar (*vetting*), të dorëzuar pranë ILDKPKI-së, më datë 25.01.2017.

56. *Moskonsiderimi nga Komisioni si burim të ardhurash për blerjen e apartamentit në analizën financiare të shumës prej 700.000 lekësh, e cila ka qenë e depozituar në llogarinë e bashkëshortes së tij, është i padrejtë, pasi kjo vlerë është krijuar me burime të ligjshme nga puna e saj.*

Ky shkak i ankimit i referohet faktit se Komisioni në llogaritjen e burimeve të ligjshme të përdorura prej subjektit për pagimin e këstit të parë të këtij apartamenti nuk ka përfshirë shumën prej 700.000 lekësh të deklaruar nga subjekti si burim për pagimin e këstit të parë në deklaratën periodike të vitit 2011. Sipas deklaramit të subjektit në atë deklaratë, si dhe në shpjegimet e dhëna si gjatë hetimit administrativ, por edhe në ankim, pretendohet se kjo shumë e cila konsistonte në një sasi parash të akumuluar si pasojë e shtesave progresive në vite prej bashkëshortes së tij, znj. R. T., në llogarinë e saj depozitë pranë Bankës Raiffeisen, në vitin 2010 është përdorur prej tij si burim për pagimin e këstit të parë për blerjen e apartamentit në mars të vitit 2011.

Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e gjyqimit, rezulton se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, znj. R. T., ka pasur në llogarinë depozitë pranë Bankës Raiffeisen shumën prej 764.925 lekësh në datën 12.11.2010, shumë e cila është transferuar po në këtë datë në favor të nënës së bashkëshortes së subjektit, shtetases H. S.. Në datën 14.01.2011, prej kësaj llogarie është tërhequr në *cash* shuma prej 700.000 lekësh⁶, pa përshkruar në dokumentacionin përkatës ndonjë shënim/përshkrim/detajim për arsyen e veprimit të kryer.

Për shkak të kësaj situatë faktike që provon faktin se subjekti i rivlerësimit nuk i dispononte si pasuri të tij këtë sasi parash në datën 04.03.2011, pasi ajo kishin kaluar në pronësi të nënës së bashkëshortes së tij, duke e zhveshur nga pronësia mbi të edhe bashkëshorten, edhe atë vetë, Kolegji çmon se me të drejtë Komisioni nuk e ka konsideruar këtë shumë si një burim për pagimin e këstit të parë për blerjen e apartamentit. Subjekti nuk ka pretenduar dhe as ka shpjeguar në asnjë formë gjatë hetimit pse kjo sasi parash, megjithëse kaluan nga depozita e bashkëshortes së tij tek ajo e nënës së saj dhe u tërhoqën *cash* që në datën 14.01.2011, mbetën përsëri në pronësi të tij dhe, si të tilla, të vlefshme për t'u konsideruar si burim për krijimin e pasurisë në mars 2011. Pretendimi i subjektit se i gjithë transaksioni bankar për lëvizjen e shumës, ishte për shkak të transferimit të vendbanimit të familjes së tij nga Dibra në Tiranë, mbetet një argument i dobët dhe i pabesueshëm, duke konsideruar natyrën virtuale të qarkullimit të parasë në sistemet bankare dhe fleksibilitetit që të krijon kjo mënyrë e administrimit të parasë.

Përveç këtij argumenti logjik, Kolegji vëren gjithashtu se me të drejtë Komisioni ka konstatuar që subjekti nuk e ka deklaruar këtë shumë në deklaratën periodike të vitit 2010 si gjendje likuiditet në bankë, pikërisht për shkak të faktit se kjo shumë nuk gëzohej më prej tij. Ai gjithashtu nuk ka deklaruar në shkelje të detyrimeve të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, "Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", i ndryshuar (në vijim "ligji nr. 9049/2003") as pakësimin e llogarisë depozitë në emër të bashkëshortes së tij, duke u shtuar argumenteve logjike të përdorura më lart edhe shkeljen e ligjit në mënyrën e deklarimit të pasurive në pronësi, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9049/2003, duke shkelur detyrimin për deklarimin e çdo shtese apo pakësimi të pasurisë në deklaratat periodike.

Në përfundim të kësaj analize, Kolegji çmon se me të drejtë Komisioni nuk ia ka llogaritur shumën prej 700.000 lekësh, të pretenduar prej subjektit, si burim financiar të ligjshëm për financimin e pagimit të këstit të parë për blerjen e apartamentit.

⁶ Veprime që konfirmohen sipas shkresës kthim përgjigjeje të Bankës Raiffeisen, me nr. {***} prot., datë 19.04.2018.

57. *Nga Komisioni është aplikuar një metodologji e gabuar lidhur me llogaritjen e shpenzimeve të jetesës, të cilat janë komponenti i analizës financiare të kryer për subjektin e rivlerësimit, tek e cila shpenzimet për frymë të llogaritura janë më të larta se ato të publikuara ndër vite nga INSTAT-i⁷ dhe të aplikuara nga ILDKPKI-ja gjatë veprimtarisë së saj për kontrollin dhe verifikimin e pasurisë së subjekteve deklaruese në vite.*

Në analizë të këtij pretendimi të ngritur në ankim nga subjekti i rivlerësimit, Kolegji shqyrtoi analizën financiare të kryer për çdo vit nga Komisioni dhe konstatoi se prej tij është aplikuar një metodologji e tillë, sipas së cilës vlera në total e shpenzimeve për jetesë të subjektit të rivlerësimit, sipas raportit të hartuar prej ILDKPKI-së, është pjesëtuar për numrin e viteve gjatë të cilave ajo është shpenzuar me qëllim nxjerrjen e shpenzimeve mesatare vjetore të çdo viti përgjatë kësaj periudhe. Sipas kësaj metodologjie, është pjesëtuar shuma e shpenzimeve totale prej 8.000.000 lekësh me 14 vite të deklarimit dhe ka rezultuar shuma prej 571.429 lekësh, vlerë e cila është konsideruar njësoj për të gjitha vitet e deklarimit, si shpenzimi për jetesë prej subjektit të rivlerësimit.

Në këtë kontekst, Kolegji mori në shqyrtim këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit dhe kreu analizën financiare për periudhën 2004-2010 dhe tre muajt e parë të vitit 2011, duke përdorur të dhënat e publikuara nga INSTAT për konsum ushqimor për frymë dhe familjar, referuar për llogaritjes aritmetike dhe logjike, të cilat janë përdorur në vite nga ILDKPKI-ja gjatë ushtrimit të kontrollit nga ky institucion.⁸ Sipas kësaj analize të re financiare, lidhur me shpenzimet e jetesës së subjektit të rivlerësimit për vitet 2004-2010, të kryer nga Kolegji me qëllim për të identifikuar mundësinë reale të subjektit të rivlerësimit për të kryer kursimet e deklaruara prej tij në deklaratat periodike dhe blerjen e pasurive, rezultoi se burimet e tij të ligjshme financiare për të përballuar shpenzimet dhe krijimin e pasurive të deklaruara në këtë periudhë paraqiteshin me një gjendje financiare negative, në një vlerë prej 884.714 lekësh. Kjo situatë financiare mbetet ajo që do të konsiderohet prej Kolegjit në vlerësimin që do t'i kryhet kriterit të kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij në kuptim të këtij procesi.

58. *Analiza financiare vit pas viti, e kryer nga KPK-ja për periudhën 2003-2012, është e pasaktë, krahasuar kjo analizë edhe me analizën financiare të paraqitur nga vetë subjekti për secilin nga këto vite.*

Në analizë të këtij shkakui ankimi, Kolegji mori në shqyrtim pretendimet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me disa të dhëna të konsideruara në analizën financiare në Komision, të cilat sipas subjektit nuk ishin konsideruar drejt dhe konform dokumentacionit të gjendur në dosje.

Së pari, subjekti pretendon se ka gabime në llogaritjen e të ardhurave në vite nga puna e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, znj. R. T.. Subjekti ka pretenduar se Komisioni ka referuar në analizën financiare të dhëna të pasakta në lidhje me këto të ardhura, duke pretenduar shuma të ndryshme për këtë zë përkatësisht në vitet 2008 dhe 2012. Kolegji, pasi verifikoi dokumentacionin e administruar në fashikull, i nënshtroi analizës financiare, në këtë zë, shumat e përcaktuara në vërtetimet e lëshuara nga qendra e punës dhe ato të dala nga analizimi i pasqyrës së gjendjes bankare (*statement*) për të ardhurat e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, të cilat u konstatuan se ishin në vlera të ndryshme nga ato të pretenduara prej subjektit.

⁷ INSTAT-i, në zbatim të ligjit nr. 9180, datë 05.02.2004, "Për statistikat zyrtare", është institucioni kryesor prodhues i statistikave zyrtare.

⁸ Shpenzimet e jetesës janë për llogaritje sipas shkresës së ILDKPKI-së nr. {***}, datë 04.03.2019 dhe protokolluar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 04.03.2019.

Së dyti, subjekti pretendon se në analizën financiare të Komisionit, të ardhurat e krijuara nga shitja e automjetit me targa {***} në vitin 2007, në vlerën prej 400.000 lekësh, nuk janë konsideruar si burim për blerjen e shtëpisë. Kolegji, pasi shqyrtoi këtë pretendim të subjektit dhe konkludoi se me të drejtë Komisioni nuk e ka konsideruar atë vlerë si një prej burimeve të përdorura për blerjen e apartamentit, për faktin se vetë subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar në deklaratën vjetore periodike të vitit 2011 shumën e ardhur nga shitja e automjetit si një nga burimet e posaçme të financimit të blerjes së apartamentit, por ka deklaruar si të tillë vetëm kursimet e deklaruara prej tij në vite, në të cilat logjikisht është përfshirë edhe kjo shumë.

Së treti, llogaritja e shpenzimeve për udhëtimet jashtë shtetit të kryera nga subjekti i rivlerësimit, janë kontestuar prej tij jo në mënyrë të shprehur e të arsyetuar, por duke vendosur në analizën financiare të paraqitur prej tij, vlera të ndryshme për këtë zë, nga sa ka përcaktuar Komisioni. Kolegji pasi verifikoi këtë situatë faktike në raport edhe me metodologjinë e miratuar e pranuar tashmë prej jurisprudencës së tij⁹, konkludoi se shpenzimet e llogaritura prej Komisionit për këtë zë ishin të paktën jo më të larta se ato që do të rezultonin nëse zbatoheshin metodologjia e mësipërme, për pasojë ato u konsideruan të drejta.

Së katërti, në lidhje me shkakun e ankimit që i referohet analizës së gabuar financiare, sipas së cilës subjekti ka mungesë të burimeve të ligjshme për të justifikuar blerjen e automjetit në vitin 2008, në vijim të verifikimit të analizës financiare, Kolegji konstatoi se me të drejtë Komisioni ka konkluduar se ai nuk ka pasur burime të ligjshme për të blerë në vitin 2008 automjetin tip “Mercedes-Benz”, me traga {***}, prodhim i vitit 1997, me vlerë 700.000 lekë. Sipas analizës financiare të kryer në Kolegj, edhe duke reflektuar pretendimet e subjektit të rivlerësimit për sa më sipër, rezulton se situata e tij financiare tregon se ai nuk ka pasur në këtë vit burime të ligjshme për të financuar dhe përballuar shpenzimet për jetesë dhe blerjen e automjetit në masën prej 384.342 lekësh.

59. Pasi në analizën financiare të kryer në Kolegj u reflektuan disa prej pretendimeve të subjektit të rivlerësimit që u gjenden të drejta dhe u shqyrtuan të gjitha faktet që lidheshin me situatën financiare të subjektit, Kolegji arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit, pavarësisht korrektimit të rezultatit negativ të konkluduar prej Komisionit në shumën prej 1.481.091 lekësh, mbetet me një balancë negative në përfundim të analizës financiare të kryer në Kolegj për vitet 2004-2012, në shumën 884.714 lekë.
60. Kolegji verifikoi në këndvështrim të shqyrtimit të shkaqeve të ankimit edhe pretendimet që lidheshin më një analizë financiare të pasaktë, e cila kishte çuar në konkluzionin se subjekti nuk arrinte të justifikonte me burime të ligjshme plotësisht edhe pasurinë llogari bankare në Bankën Credins, e krijuar më datë 28.10.2016, në shumën prej 2.500.000 lekësh.

Sipas pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, ky konkluzion i gabuar i Komisionit, përveç afektimit nga analiza e gabuar financiare për vitet 2004-2012, të shqyrtuar më lart, ishte rezultat edhe i faktit se shifra prej 1.665.528 lekësh, e vendosur në tabelën e analizës financiare të Komisionit, në zërin “Likuiditete në fund të vitit”, për vitin 2012, nuk është e saktë, pasi në vitin 2012 subjekti në llogarinë e tij bankare pretendon se ka pasur gjendje 12.574 lekë dhe 13.460 lekë në llogarinë bankare të bashkëshortes dhe nuk ka mundësi që likuiditetet të jenë në masën e konsideruar nga Komisioni. Pas shqyrtimit të këtij pretendimi të subjektit, Kolegji konstatoi se Komisioni në tabelën e analizës financiare për vitin 2012, ka reflektuar në gjendjen e likuiditeteve

⁹ Shih vendimin nr. 11/2019 (JR), datë 22.05.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

të dhënat sipas deklaramit të subjektit në deklaratën periodike të atij viti, të gjendjeve në llogarinë bankare dhe të likuiditeteve *cash* (dhe jo vetëm gjendjen në llogarinë bankare), që në thelb përbëjnë të gjithë shumën e likuiditeteve në fund të këtij viti për subjektin e rivlerësimit. Për këtë arsye, ky pretendim i subjektit të rivlerësimit u konsiderua i pabazuar dhe situata financiare e subjektit edhe për këtë pasuri, sipas analizës së bërë në Kolegj, mbeti përsëri negative në vlerën prej 106.601 lekë, edhe pasi në të u reflektuan të gjitha pretendimet e subjekti për analizën financiare të viteve 2004-2012.

61. Në përfundim të shqyrtimit të shkaqeve të ankimit të cilat lidhen me analizën financiare të kryer në Komision për subjektin e rivlerësimit, Kolegji arrin në konkluzionin se pavarësisht rezultateve të ndryshme të dala nga analiza financiare e kryer në Kolegj, në përgjigje edhe të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, situata e tij financiare mbetet përsëri negative dhe nuk arrin të justifikojë me burime të ligjshme as pagimin e këstit të parë prej 20.000 eurosh për blerjen e apartamentit në mars të vitit 2011, as blerjen e pasurive të deklaruara e të gjitha shpenzimeve të kryera e të llogaritura për jetesën e tij dhe të familjes përgjatë viteve 2004-2012¹⁰, duke u klasifikuar kjo situatë faktike sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.
62. Në lidhje me shkakun e ankimit sipas të cilit Komisioni ka gabuar lidhur me konsiderimin si fshehje pasurie të mosdeklarimit prej subjektit të rivlerësimit të objektit me sipërfaqe prej 32 m² në truall të zënë prej 450 m² në Paskuqan, Kolegji pasi shqyrtoi dhe analizoi të gjitha rrethanat e faktit dhe parashikimet ligjore përkatëse, arriti në konkluzionin se qëndrimi i Komisionit për këtë çështje është i drejtë dhe i mbështetur në fakte e në ligj.
63. Nga shqyrtimi gjyqësor, Kolegji konstatoi se nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni, por edhe nga kontrolli periodik i kryer nga ILDKPKI-ja në vitin 2016, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar marrëdhënien e tij me një objekt të ndërtuar pa leje ndërtimi me sipërfaqe 32 m², i vendosur në një sipërfaqe prej 450 m² truall të ndodhur në {***}, Tiranë. Lidhur me këtë objekt, nga hetimi i kryer në vitin 2016 nga ILDKPKI-ja, ka rezultuar se në emër të subjektit të rivlerësimit është regjistruar në zyrat e ALUIZNI-t një vetëdeklarim për legalizim të këtij objekti, i cili është bërë në 07.11.2006, fakt i cili i është bërë i ditur subjektit të rivlerësimit në vitin 2016, për shkak të kryerjes së kontrollit periodik nga ILDKPKI-ja. Referuar deklaramimeve periodike të pasurisë të kryera prej subjektit për vitin 2006 e në vijim, si dhe atyre në deklaratën *vetting*, është konstatuar se në asnjë rast subjekti nuk ka deklaruar marrëdhënien e tij ligjore me objektin pa leje ndërtimi prej 32 m², me sipërfaqe truall të zënë 450 m² në {***}. Lidhur me mosdeklarimin e këtij objekti, subjekti gjatë procesit të tij të rivlerësimit të kryer në Komisioni, me shpjegimet për rezultatet e hetimit, por edhe në seancën dëgjimore publike, ka shpjeguar se formulari i vetëdeklarimit, i dorëzuar panë ALUIZNI-t në vitin 07.11.2006, është plotësuar prej babait të tij dhe se objekti i deklaruar është një kasolle dhe është ndërtuar me qëllimin e vetëm për të përfituar sipërfaqen e truallit të zënë. Ai ka shpjeguar gjithashtu se babai i tij kishte një sipërfaqe prej 1.000 m², të blerë në vitin 1997 dhe se, përveç banesës së tij, në këtë truall kishte ndërtuar këtë kasolle dhe e kishte paraqitur për legalizim në emrin e subjektit të rivlerësimit.
64. Nga shpjegimet e dhëna në Komision, rezulton gjithashtu se subjekti i rivlerësimit ka pohuar faktin që prej ILDKPKI-së, gjatë procedurës së kontrollit në vitin 2016, ka marrë dijeni për ekzistencën e këtij formulari vetëdeklarimi, por thekson se ai vetë nuk ka aplikuar asnjëherë pranë ALUIZNI-t. Gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur një akt

¹⁰ Nga analiza ekonomike e kryer në Kolegj për periudhën 2004-2012, në vitet 2005, 2007, 2008 dhe 2012, subjekti i rivlerësimit rezulton me balancë negative të mbulimit të shpenzimeve me të ardhurat.

ekspertimi tekniko-grafik të kryer nga eksperti i kriminalistikës, z. V. H., me anë të të cilit ka synuar të provojë faktin se firma e hedhur në formularin për vetëdeklarim pranë ALUIZNI-t, për objektin 32 m² në {***}, nuk është e tija. Komisioni ka konkluduar, si pasojë e analizimit të këtyre fakteve, se subjekti i rivlerësimit ka fshehur këtë pasuri, duke mos e deklaruar atë.

65. Kolegji, pasi shqyrtoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me këtë pasuri dhe analizo situatën faktike e ligjore që lidhet me të, vlerëson se subjekti i rivlerësimit, në zbatim të nenit 30 e 31 të ligjit nr. 84/2016 e të shtojcës 2 bashkangjitur këtij ligji, kishte detyrimin të deklaronte marrëdhënien e tij me këtë pasuri, e cila gjendet e formalizuar në formularin e vetëdeklarimit të paraqitur tek ALUIZNI. Neni 3, pika 11 e ligjit nr. 84/2016 parashikon: *“Pasuri” janë të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, sipas parashikimit të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, që janë në pronësi, posedim ose në përdorim të subjektit të rivlerësimit.*

Ndërkohë që sipas nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003 parashikohet se: *Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të interesave privatë, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si më poshtë:*

a) *pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil [...].*

66. Në kontekst të kësaj situatë faktike dhe ligjore, në dijeni të plotë të subjektit të rivlerësimit pas komunikimeve me institucionin përgjegjës për kontrollin e verifikimin e pasurisë në vitin 2016, subjekti i rivlerësimit kishte ndërgjegjësimin e duhur për të deklaruar këtë marrëdhënie të tij me këtë pasuri në deklaratën *vetting*, qoftë edhe sikur të bënte në të shpjegimet e nevojshme apo të përshtatshme të rastit, sipas pretendimit të tij se ajo pasuri i përkiste babait të tij. Ekzistenca e vetëdeklarimit pranë ALUIZNI-t për të drejtat e subjektit mbi këtë pasuri, tregon në kuptim formal deri në provimin e së kundërtës se këto të drejta i përkasin pikërisht subjektit të rivlerësimit, prandaj ai kishte detyrimin, në zbatim të nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, t'i deklaronte ato. Kjo sjellje e subjektit, nëse do të kishte ndodhur, do të kishte eliminuar shkakun kushtetues të përpjekjes për të fshehur pasurinë dhe do të vlerësohej si një vullnet i qartë për të deklaruar gjithçka në përputhje me ligjin, duke i prezantuar të gjitha rrethanat e plota që përcaktojnë situatën. Në të njëjtën linjë shkojnë edhe përpjekjet e mëpasshme të subjektit, pas marrjes së vendimit të Komisionit për shkarkimin e tij për të hequr dorë nga të drejtat pasurore mbi këtë pasuri, në favor të babait të tij, me qëllim shmangien e përgjegjësisë nga zbatimi i masës disiplinore. Mosdeklarimi i kësaj marrëdhënieje dhe përpjekja për t'ia faturuar pronësinë mbi të babait të tij, pasi ky element është evidentuar nga hetimi që ka zhvilluar Komisioni, është konsideruar me të drejtë prej tij si përpjekje e subjektit për të shmangur përgjegjësinë për mosdeklarimin e kësaj marrëdhënieje, për pasojë klasifikimin e saj si fshehje e pasurisë, në kuptim të nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016.

67. Në lidhje me shkakun e ankimit nëpërmjet të cilit subjekti i rivlerësimit kundërshtoi konkluzionin e Komisionit për fshehje të pasurisë automjet tip “Volkswagen Tiguan”, me targë fillestare {***}, të regjistruar në emër të vëllait të subjektit të rivlerësimit, z. N. T., Kolegji pasi shqyrtoi pretendimet e parashtruara në ankim dhe dokumentacionin e administruar gjatë hetimit, e konsideron si të pambështetur në fakte e në ligj, duke arsyetuar si vijon.

68. Në vendimin e Komisionit nr. 77, datë 15.11.2018, lidhur me këtë automjet është pasqyruar se nga hetimi i kryer, duke u nisur nga të dhënat e sistemit TIMS, i është kërkuar DPSHTR¹¹ të përcjellë të gjitha dosjet e mjeteve motorike me të cilat subjekti i rivlerësimit ka bërë hyrje-dalje në kufi. Nga verifikimi i të dhënave të nxjerra nga sistemi TIMS dhe i dosjeve të mjeteve, Komisioni ka konstatuar se mjeti me targë {***}, i cili ka figuruar në pronësi të vëllait të subjektit, z. N. T., është përdorur prej subjektit të rivlerësimit disa herë gjatë daljeve jashtë shtetit dhe, pavarësisht këtij fakti, subjekti nuk e ka deklaruar asnjëherë. Nga hetimi i kryer, ka rezultuar gjithashtu se në policat e sigurimit për automjetin me targë {***}, në periudha të caktuara të viteve nga 2014 deri në vitin 2017, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij janë shënuar si “përdorues”. Subjekti i rivlerësimit është pyetur gjatë hetimit administrativ nga Komisioni lidhur me mjetet e përdorura prej tij dhe ai ka deklaruar përdorimin e disa automjeteve të tjera, por në asnjë rast nuk ka deklaruar përdorimin e këtij automjeti prej tij. Bazuar në këto konstatime, si edhe në faktin se vëllai i subjektit të rivlerësimit ka qenë në pamundësi financiare për të blerë këtë automjet, Komisioni ka konkluduar se subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm duke mos deklaruar përdorimin e tij dhe se ai është një automjet i blerë prej subjektit të rivlerësimit (me burime të pajustificuara), i cili është përdorur prej tij, por është regjistruar në emër të personave të tjerë, me qëllim fshehjen e tij.
69. Në ankimin e tij lidhur me automjetin “Volkswagen Tiguan”, me targë {***}, subjekti kundërshton këtë qëndrim të mbajtur në vendimin nr. 77, datë 15.11.2018, duke u shprehur se Komisioni nuk ka arritur të arsyetojë tej çdo dyshimi të arsyeshëm se shtetasi N. T. është person i lidhur në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, pasi dispozita kërkon të provojë lidhjen ndërmjet palëve me një marrëdhënie juridike të shfaqur në formën e dhurimit apo huas. Në shpjegimet e dhëna gjatë hetimit, por edhe në ankim, subjekti lidhur me këtë automjet shpjegon se automjeti “Volkswagen Tiguan” është përdorur prej tij vetëm për daljet jashtë shtetit, meqenëse automjeti që ai kishte në pronësi (“Mercedes-Benz”) nuk kishte siguracion ndërkombëtar, për shkak të pamundësisë për blerjen e një siguracioni ndërkombëtar me vlerë 400 euro, e cila lidhet me nivelin racional të jetës së kryer prej tij.
70. Në analizë të arsyetimit dhe qëndrimit të mbajtur nga Komisioni për automjetin “Volkswagen Tiguan”, me targë {***}, si dhe pretendimet e bëra në ankim lidhur me të nga subjekti i rivlerësimit, Kolegji çmon se konkluzioni i arritur prej Komisionit në lidhje me këtë pasuri është i drejtë.

Kolegji vlerëson së pari se, referuar situatës faktike të përdorimit të automjetit prej subjektit të rivlerësimit të provuar gjatë hetimit në Komision, ai kishte detyrimin të deklaronte këtë marrëdhënie në zbatim të përcaktimeve të nenit 3, pika 11 e ligjit nr. 84/2016, në të cilën jepet përkufizimi i fjalës “pasuri”, duke u përcaktuar se: *Pasuri janë të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, sipas parashikimit të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2013, “Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, që janë në pronësi, posedim ose në përdorim të subjektit të rivlerësimit. Ky parashikim, i parë në harmoni me nenin 30 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit: Objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarami dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij, detyronte subjektin e rivlerësimit të deklaronte përdorimin e këtij automjeti si një pasuri në përdorim të tij, përderisa nga policat e sigurimit me nr. serie {***}, lëshuar nga shoqëria “{***}”, ai rezultonte se kishte të drejta përdorimi mbi këtë automjet për periudhën e sigurimit 24.06.2016 - 23.06.2017, periudhë e cila përfshin brenda saj kohën e depozitimit të deklaratës së pasurisë vetting në datën 25.01.2017.*

¹¹ Drejtoria Përgjithshme e Transportit Rrugor.

71. Në këtë kontekst, Kolegji çmon se ky konkluzion i Komisionit është i drejtë dhe se subjekti ka shkëlur detyrimet kushtetuese dhe ligjore me mosdeklarimin e këtij fakti. Në vijim të konkluzionit të mësipërm, Kolegji konstaton se përtej faktit të mosdeklarimit në deklaratën *vetting* të faktit të përdorimit të automjetit, subjekti ka refuzuar të deklarojë këtë fakt edhe përgjatë hetimit administrativ, ku ai është pyetur në mënyrë të posaçme nga Komisioni nëse ai ka përdorur automjete të tjera të cilat figurojnë në pronësi të personave të tretë. Ndërsa ka dhënë shpjegime për automjete të tjera, të cilat¹² madje edhe nuk i ka përdorur me të njëjtën frekuencë sa ajo e përdorimit të këtij automjeti, subjekti nuk ka dhënë asnjë shpjegim për marrëdhënien e tij me këtë automjet, megjithëse sipas policave të sigurimit të administruara gjatë hetimit administrativ, rezultonte se ai dhe bashkëshortja e tij të kishin gëzuar të drejta përdorimi mbi këtë automjet për një periudhë trevjeçare, 2014-2017.

Në vijim të këtij arsytimi, pra faktit se ai e ka përdorur automjetin dhe nuk e ka deklaruar këtë fakt duke e fshehur atë, i shtohet situata faktike e rezultuar nga hetimi, se vëllai i subjektit të rivlerësimit, i cili, sipas akteve përkatëse, rezulton të ketë blerë automjetin në vitin 2014, nuk kishte sipas analizës financiare të kryer në Komision, por edhe në Kolegji, burime të mjaftueshme financiare për ta blerë këtë pasuri në këtë vit¹³. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit se vëllai i tij nuk duhet të konsiderohet si person tjetër i lidhur, pasi ai nuk gjendet, sipas tij, në një raport interesi me të apo në kushtet e nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, konsiderohet i pabazuar në vlerësim të Kolegjit. Për shkak se konsiderohet i provuar gjatë hetimit administrativ, edhe nga pohimet e vetë subjektit të rivlerësimit, fakti i përdorimit të automjetit “Volkswagen Tiguan”, me targë {***} për një periudhë të gjatë kohe trevjeçare, në mënyrë konstante dhe të qëndrueshme, Kolegji çmon se kjo marrëdhënie duhet të konsiderohet të paktën si një marrëdhënie huapërdorje, sipas parashikimeve të nenit 901 e vijues të Kodit Civil, e cila përfshihet te marrëdhënia e huas që parashikon neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, marrëdhënie e cila kategorizon vëllain e subjektit në këtë rast si person tjetër të lidhur për këtë pasuri dhe passjell detyrimin e subjektit të rivlerësimit për të provuar burimin e ligjshëm të kësaj pasurie¹⁴.

Kjo situatë faktike e pranuar edhe prej subjektit të rivlerësimit, e vlerësuar në harmoni me faktet e tjera që kanë rezultuar në lidhje me këtë pasuri e që janë përshkruar më lart, së bashku e çojnë Kolegjin në konkluzionin se marrëdhënia e huapërdorjes me automjetin, e pretenduar prej subjektit, është në fakt një përpjekje për të fshehur një marrëdhënie pronësie të subjektit me këtë pasuri. Ky fakt jo në mënyrë të drejtpërdrejtë, por në terma të përgjithshëm, ka qenë pjesë edhe e denoncimit nga publiku¹⁵, sipas të cilit thuhej se makinat që përdoren prej subjektit janë të regjistruara në emër

¹² I pyetur nga ana jonë, nëse ka përdorur në shtatë vitet e fundit pasuri të regjistruara në emrin e dikujt tjetër (si automjete, shtëpi, anije, apartamente, shtëpi pushimi etj.), në përgjigjet e përcjella pranë Komisionit, me shkresën e Prokurorisë së Përgjithshme nr. {***} prot., datë 20.12.2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se për këto vite, në cilësinë e drejtuesit të Prokurorisë Vlorë ka përdorur automjetin e Prokurorisë së Përgjithshme, me targë {***}, dhe se, nga muaji nëntor 2017 dhe deri në momentin e deklarimit po përdor autoveturën me targë {***}, që është në pronësi të shtetasit G. H., me të cilin deklaroi se ka lidhje shoqërie dhe krushqie. Gjithashtu, ka deklaruar se në vitin 2011 ka përdorur (pa akt përdorimi) disa muaj një automjet tip “Mercedes-Benz”, me targë {***}, që i përkiste shtetasit E. D., kjo për faktin se për të shkuar në Prokurorinë e Rrethit Dibër ku punonte në atë kohë, udhëtonte nga Maqedonia dhe se ky automjet ishte me siguracion ndërkombëtar.

¹³ Referuar analizës financiare të kryer si nga Komisioni, ashtu edhe nga Kolegji, duke marrë në konsideratë të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet për të cilat ka të dhëna të administruara në fashikull gjatë hetimit për N. T., për periudhën 2006-2014, situata e tij financiare rezultoi me balancë negative në vlerën 18.464.898 lekë.

¹⁴ Shih vendimin nr. 15, datë 17.07.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

¹⁵ Denoncim i bërë nga shtetasi A. H., i regjistruar nga KPK me nr. {***} prot., datë 15.02.2018, i administruar në fashikull.

të vëllait të tij, z. N. T.. Krahas këtyre argumenteve, duke i vendosur në panoramën e përgjithshme të kësaj situate faktike, sjellin një informacion që mbështet dyshimet e ngritura rreth pronësisë së fshehur të automjetit edhe të dhënat e targës së këtij mjete, të cilat përkojnë me vitin e lindjes dhe inicialet e emrit dhe mbiemrit të subjektit të rivlerësimit. Ky informacion vlen të përmendet si një informacion periferik, por që simbolizon në dukje marrëdhënien që ka subjekti i rivlerësimit me këtë pasuri.

72. Në përfundim, Kolegji, duke analizuar konkluzionet e mësipërme në raport me njëra-tjetrën dhe duke vlerësuar sjelljen e subjektit në raport me këtë pasuri, si edhe përpjekjen e tij për të manipuluar të vërtetën e për mos ta bërë atë të ditur për organet e rivlerësimit, çmon se konkluzioni i Komisionit që automjeti tip “Volkswagen Tiguan”, me targë fillestare {***}, me të drejtë është konsideruar si pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit, sipas parashikimeve të nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016.
73. Në lidhje me shkakun tjetër të ankimit të subjektit të rivlerësimit, sipas të cilit ai kundërshton si qëndrimin e mbajtur nga Komisioni për konsiderimin si person tjetër të lidhur të vëllait të tij, z. N. T., dhe analizën financiare të kryer për të, ashtu edhe konkluzionin e arritur nga Komisioni se pasuritë e vëllait duhet të konsiderohen si pasuri të fshehura prej subjektit, duke i regjistruar në emër të personave të tretë, Kolegji pasi shqyrtoi pretendimet e tij dhe aktet e administruara në fashikullin e gjyqimit, arriti në konkluzionin se ky pretendim i subjektit qëndron dhe se Komisioni (përfundimtar qëndrimin të mbajtur për automjetin “Volkswagen Tiguan”) ka gabuar në këtë konkluzion të tij.
74. Nga analizimi i vendimit të Komisionit lidhur me pasuritë e vëllait të subjektit të rivlerësimit, z. N. T., rezulton se nga denoncimi i ardhur pranë Komisionit (i cituar më lart), hidhen dyshime për disa pasuri të ndodhura në të njëjtin objekt, tek {***}, kompleksi “{***}”, si apartamente, njësi shërbimi e garazhe, të cilat pretendohet se janë pasuri të krijuara me burime jo të ligjshme nga ana e subjektit të rivlerësimit, por që janë regjistruar në emër të familjarëve të tij. Nga verifikimi i bërë gjatë hetimit, është konstatuar se në këtë objekt, përveç apartamentit të blerë nga ana e subjektit të rivlerësimit, janë të regjistruara edhe disa pasuri në emër të familjarëve të tij¹⁶.
75. Në vendim, Komisioni ka arsyetuar se referuar pikës 14 të nenit 2, si edhe pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, vëllai i subjektit të rivlerësimit, z. N. T., bën pjesë në kategorinë e personave të tjerë të lidhur, të cilët kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive. Në vijim të këtij arsyetimi, Komisioni ka kryer analizën financiare për vëllain e subjektit të rivlerësimit, z. N. T., nga e cila ka rezultuar se ai në vitet kur ka krijuar pasuritë e përmendura në denoncim, ka qenë me mungesë të burimeve të ligjshme në masën 19936489 lekë për t’i krijuar ato. Mbështetur në këtë konkluzion mbi analizën financiare të vëllait të subjektit të rivlerësimit, Komisioni ka arritur në konkluzionin se ato pasuri, duke mos qenë e mundur të krijohen ligjërisht prej tij, janë pasuri të fshehura të subjektit të rivlerësimit, të krijuara prej tij me burime të jashtëligjshme.

¹⁶Pasuritë e regjistruara në emër të familjarëve të subjektit të rivlerësimit, të evidentuara nga hetimi administrativ e të dhëna në vendim janë:

- i. në emër të vëllait të subjektit, z. N. T., janë të regjistruara 1 (një) apartament dhe 3 (tre) njësi shërbimi, pasuri të cilat konfirmohen edhe me shkresën nr. {***} prot., datë 28.02.2018, të ZVRPP-së Tiranë;
- ii. në emër të z. V. S. dhe znj. K. S. (baxhanaku dhe kunata e subjektit) është i regjistruar 1 (një) apartament dhe një/dy garazhe;
- iii. në emër të z. R. M. dhe znj. E. M. (baxhanaku dhe kunata e subjektit) është e regjistruar 1 (një) njësi shërbimi.

76. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar këtë konkluzion të Komisionit, duke pretenduar në ankim se *së pari*, Komisioni nuk ka arritur të arsyetojë tej çdo dyshimi të arsyeshëm se vëllai i tij N. T. është person tjetër i lidhur, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, pasi kjo dispozitë kërkon të provohet lidhja ndërmjet palëve përmes një marrëdhënieje juridike të shfaqur si dhurim, hua apo huamarrës dhe *së dyti*, analiza financiare e kryer për vëllain e tij, përveçse është e pajustificuar ligjërisht, është edhe e pasaktë, pasi vëllai ka pasur të ardhura për të krijuar këtë pasuri, të cilat i ka përfituar nga aktiviteti i tij tregtar që realisht ka qenë me të ardhura/fitime më të mëdha nga ato që vëllai i tij ka deklaruar në organet tatimore. Këto të ardhura janë deklaruar nga vëllai i subjektit të rivlerësimit nëpërmjet një deklarate noteriale nr. {***} rep. dhe nr. {***} kol., të datës 19.10.2018, e cila është përcjellë pranë Komisionit nga vetë subjekti, me shpjegimet e tij për rezultatet e hetimit.
77. Në analizë të këtij shkak ankimi, Kolegji çmon se pretendimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me këtë konkluzion, është i drejtë. Së pari, nga analiza e situatës faktike që është e provuar nga hetimi administrativ, nuk rezulton se midis subjektit të rivlerësimit dhe vëllait të tij, z. N. T., të ketë një marrëdhënie biznesi në kuptim të nenit 3, pika 14 e ligjit nr. 84/2016 dhe as një marrëdhënie huamarrjeje apo dhurimi në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, përveç asaj të përshkruar më lart, që lidhet me përdorimin e automjetit tip “Volskwagen Tiguan”, për të cilën është mbajtur një qëndrim ligjor nga Kolegji.
78. Në këtë kuptim, vëllai i subjektit të rivlerësimit, z. N. T., nuk duhet të trajtohet si person tjetër i lidhur, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, në funksion të detyrimit të subjektit të rivlerësimit për të provuar ligjshmërinë e burimit të çdo pasurie që figuron e regjistruar apo në përdorim të tij. Në vijim edhe të jurisprudencës së Kolegjit në këtë drejtim, subjekti i rivlerësimit do të ketë detyrimin të provojë, për llogari të këtij procesi, burimet e ligjshme të pasurisë së personit tjetër të lidhur, në rastin kur ajo pasuri përfaqëson një marrëdhënie për shkak të së cilës personi tjetër konsiderohet si person tjetër i lidhur i subjektit dhe kur ekzistojnë rrethanat e parashikuara nga neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Në rastin konkret, nuk rezulton, siç u përmend më lart, që subjekti i rivlerësimit të ketë me vëllain e tij ndonjë marrëdhënie huaje apo dhurimi në raport me pasuritë të cilat janë konsideruar prej Komisionit si pasuri të fshehura të subjektit të rivlerësimit. Për pasojë, subjekti i rivlerësimit nuk do të ketë, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, detyrimin të provojë burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre pasurive prej vëllait të tij, mosekzekutimi i të cilit do ta penalizonte subjektin me vendosjen e masës disiplinore, por ky konkluzion nuk kufizon Komisionin të bëjë hetimet e duhura për të verifikuar dyshimet e ngritura se këto pasuri, edhe sepse nuk ngarkohen me barrën e provimit të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre prej subjektit të rivlerësimit, janë pasuri të fshehura të vetë subjektit të rivlerësimit.
79. Përpos këtij arsytimi, Kolegji çmon se Komisioni me të drejtë ka kryer hetime për ligjshmërinë e burimeve të krijimit të këtyre pasurive prej vëllait të subjektit, por në kuadër të verifikimit të dyshimeve të bëra prezente nga denoncimi nga publiku i ardhur në Komision, sipas të cilit këto janë pasuri të fshehura të subjektit të rivlerësimit, por të regjistruara në emër të vëllait të tij. Në këtë kuptim, veprimtaria hetimore e Komisionit është e legjitimuar në vlerësimin e Kolegjit, për më tepër edhe konkluzioni i nxjerrë prej analizës financiare të kryer në Komision, mbështetur në dokumentacionin ligjor të përcjellë nga organet tatimore, sipas të cilit vëllai i subjektit të rivlerësimit nuk ka pasur burime të ligjshme për të financuar blerjen e pasurive objekt denoncimi, për një vlerë prej 19.936.489 lekësh, e cila ka rezultuar të paktën në atë vlerë edhe nga analiza financiare që u krye në Kolegj, konsiderohet i drejtë.

80. Pavarësisht këtij fakti, Kolegji konstaton se nga hetimi nuk ka rezultuar ndonjë e dhënë tjetër e cila të jepte informacion mbi marrëdhënie të mundshme të subjektit të rivlerësimit me pasuritë në emër të vëllait të tij. Rrethana të tilla, si emri i një lokali i quajtur me emrin e një prej fëmijëve të subjektit¹⁷ apo fakti që pasuritë gjenden në të njëjtin objekt ku ka blerë edhe shtëpinë subjekti, janë rrethana që nuk informojnë direkt mbi marrëdhënien e dyshuar, por as në mënyrë indirekte, pa u konsideruar si spekulative. Në këtë situatë faktike, Kolegji çmon se konkluzioni i Komisionit se këto pasuri janë pasuri të fshehura prej subjektit nuk mbështet në të dhëna që të bindin Kolegjin për të njëjtin konkluzion. Vetëm fakti i përmendur në denoncim dhe mungesa e burimit të ligjshëm të vëllait të subjektit për të krijuar këto pasuri, pa u provuar ndonjë lidhje e drejtpërdrejtë ose e tërthortë e vetë subjektit me këto pasuri, vlerësohen nga Kolegji si të pamjaftueshme për të arritur në konkluzionin se këto pasuri janë pasuri të fshehura të subjektit të rivlerësimit, duke e gjetur të pabazuar në fakte konkluzionin e Komisionit për sa më sipër.
81. Në lidhje me shkakun e ankimit sipas të cilit subjekti i rivlerësimit kundërshton qëndrimin e mbajtur nga Komisioni lidhur me pasuritë e baxhanakut të subjektit të rivlerësimit, z. R. M., konkretisht të drejtat e tij mbi aksionet në shoqërinë “{***}” ShPK, duke i konsideruar si pasuri të fshehura të subjektit të rivlerësimit, Kolegji, pasi analizoi të gjitha rrethanat e faktit që kanë rezultuar nga hetimi administrativ, arriti në konkluzionin se është një pretendim i drejtë dhe se qëndrimi i Komisionit për këtë çështje është i pabazuar në fakte.
82. Sipas vendimit të Komisionit, ka rezultuar se shtetasi R. M., baxhanaku i subjektit të rivlerësimit, ka qenë bashkaksioner me shtetasin E. D. (shtetas për të cilin subjekti deklaroi se i ka përdorur makinën dhe se evidentohet se ka disa pasuri në pallatin “{***}”, Tiranë) dhe me F. C. në shoqërinë “{***}” ShPK, me nipt {***}, e cila e ushtron aktivitetin tregtar në fushën e veprimtarisë minerare, me seli në Bulqizë. Këto aksione të fituara nëpërmjet kontratës së shitjes së kuotave në vitin 2016¹⁸, shtetasi R. M. ia ka dhuruar më pas shoqërisë “{***}” ShPK. Komisioni i ka konsideruar të dyshimta transaksionet e shtetasit R. M. për të përfituar aksionet në një shoqëri që ushtron aktivitetin si shoqëri minerare në Bulqizë, vend në të cilin subjekti i rivlerësimit ka ushtruar detyrën e prokurorit dhe sepse në vazhdimësi ka pasur nën hetim disa çështje për konsumimin e veprës penale “Shkelje e rregullave të mbrojtjes në punë”, parashikuar nga neni 289 i Kodit Penal, që lidhen me aksidente të ndodhura në minierat e Bulqizës, për të cilat ai kryesisht ka vendosur mosfillimin/pushimin e procedimeve penale. Ky situatë faktike e ka çuar Komisionin drejt dyshimit se këto aksione mund të jenë aksione të fshehura të subjektit të rivlerësimit, të regjistruara në emër të baxhanakut të tij.
83. Subjekti ka kundërshtuar këtë konkluzion, duke pretenduar se në asnjë moment nuk është provuar nga Komisioni se ka pasur ndonjë lidhje midis funksionit/detyrës së tij dhe pasurive të krijuara nga baxhanaku i tij, si dhe as ekzistenca e ndonjë konflikti të mundshëm interesi. Ai gjithashtu pretendon se ndërmjet tij dhe baxhanakut nuk ka ekzistuar dhe nuk ekziston asnjë marrëdhënie ligjore në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.
84. Nga shqyrtimi i situatës faktike që ka rezultuar e provuar gjatë hetimit, Kolegji konstatoi se dyshimet e ngritura në lidhje me këtë pasuri janë shfaqur në hetim nga denoncimi nga publiku i cituar më lart, sipas të cilit këto të drejta i përkasin subjektit të rivlerësimit. Në vijim, Komisioni ka vijuar me veprimtarinë hetimore, sipas së cilës ka rezultuar se këto aksione janë blerë prej shtetasit

¹⁷ Nga hetimi ka rezultuar se lokali i hapur prej vëllait të subjektit është quajtur “{***}”, dhe F. quhet vajza e subjektit të rivlerësimit.

¹⁸ Me anë të kontratës noteriale të shitblerjes së aksioneve nr. {***} rep., nr. {***} kol., e datës 22.11.2016.

R. M., në një vlerë të pakonsiderueshme, prej rreth 33.000 lekësh, referuar kontratës së shitjes së kuotave, shumë e cila është e përballeshme në raport me të ardhurat e këtij shtetasi, element që përjashton mundësinë e mungesës së burimeve të ligjshme për fitimin e kësaj pronësie. Gjithashtu, Komisioni ka hetuar edhe në drejtim të ndonjë situatë të mundshme konflikti interesi ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe bashkaksionerëve të shoqërisë dhe, nga përgjigjja e kthyer nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Dibër¹⁹, ka rezultuar se subjekti nuk është gjendur asnjëherë në ndonjë çështje penale më cilësinë e prokurorit, në të cilën këta shtetas të kishin qenë nën hetim. Përpos këtij fakti, nga përgjigjja ka rezultuar se këta shtetas nuk kanë qenë asnjëherë nën hetim pranë asaj zyre. Hetimi i kryer nga Komisioni ka konkluduar gjithashtu edhe në përfundimin se dhurimi i aksioneve nga baxhanaku i subjektit në nëntor 2016, ka qenë një veprim i cili ka mbështetur dyshimet për pasuri të fshehura, aq më tepër kur baxhanaku i subjektit i zhvillon këto transaksione më individë të cilët janë me origjinë nga zona e Dibrës/Bulqizës, ku zhvillojnë edhe aktivitetin, ndërsa ky shtetas është nga zona e Shijakut, duke nënkuptuar mungesën e lidhjeve krahinore e shoqërore të tij me ta dhe duke insinuar ndikimin e subjektit.

85. Kolegji, duke vlerësuar këtë situatë faktike në zbatim të parimit të objektivitetit, çmon që pavarësisht se transaksioni i kryer nga shtetasi R. M. duket si një transaksion i favorizuar nga rrethana që lidhen me origjinën e subjektit të rivlerësimit dhe vendin ku ai ka ushtruar funksionin e prokurorit për një kohë të gjatë, duke qenë se ngjan me një transaksion të paarsyeshëm në mungesë të këtyre rrethanave, pavarësisht dyshimeve që mund të ngrihen, nuk mjafton për të arritur në konkluzionin se këto pasuri janë pasuri të fshehura të subjektit të rivlerësimit. Vetë dhurimi i kuotave të një shoqërie që rezulton të ketë fitime të kënaqshme nga viti në vit, duket se është veprimi që natyrshëm të krijoj dyshime për një transaksion jo të zakonshëm e që nuk ndjek logjikën ekonomike, por që mund të jetë bërë në funksion të fshirjes së gjurmëve para nisjes së procesit të rivlerësimit, por këto dyshime apo supozime në vlerësimin e Kolegjit nuk mund të ngrihen jo vetëm në nivelin e provave, por as të indiceve, për të mbështetur një konkluzion të kësaj natyre. Nga kontrolli i aktivitetit funksional të subjektit të rivlerësimit, nuk rezulton ndonjë lidhje e tij me shtetasit bashkaksionerë në këtë shoqëri, që lidhet me ndonjë procedim penal të zhvilluar në ngarkim të tyre apo me ngjarje në të cilat ata të kenë qenë pjesërisht të përfshirë, e cila në çfarëdo forme mund të kishte dhënë informacion të besueshëm për një situatë të konfliktit të interesit e më pas të mbështetjes së idesë se këto pasuri janë të subjektit të rivlerësimit.
86. Në përfundim të shqyrtimit të këtij shkak, Kolegji arrin në konkluzionin se mbetet i pambështetur në fakte konkluzioni i Komisionit se këto pasuri të baxhanakut të tij janë pasuri të fshehura të subjektit të rivlerësimit. Pavarësisht informacioneve që përcillen nëpërmjet denoncimeve, ato mbeten në nivele të tilla kur nuk mbështeten nga prova e inidicie dhe nuk mund të ngrihen në nivelin e bindjes së trupit gjykues për vërtetësinë e tyre. Për sa më sipër, Kolegji e gjen të drejtë këtë pretendim të subjektit dhe të pabazuar konkluzionin e Komisionit, konsiderimin si pasuri të fshehura të subjektit të rivlerësimit pasuritë e regjistruara në emër të baxhanakut të tij R. M..
87. Në lidhje me shkakun e ankimit, nëpërmjet të cilit subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar konkluzionin e Komisionit se pasuria apartament e ndodhur në Tiranë, pranë {***}, është një pasuri e fshehur e subjektit, Kolegji, pasi shqyrtoi e analizoi pretendimet e subjektit, si dhe situatën faktike e ligjore që ka rezultuar nga hetimi administrativ, arriti në konkluzionin se pretendimi i subjektit nuk është i bazuar dhe se konkluzioni i Komisionit për këtë çështje është i drejtë.

¹⁹ Shkresa nr. {***} prot., datë 14.08.2018.

88. Në analizë të vendimit të Komisionit lidhur me pasurinë apartament pranë {***}, ku banon subjekti i rivlerësimit, konstatohet se hetimi për të është iniciuar nga denoncimi nga publiku i cituar më lart, në të cilin janë parashtruar informacione se kjo banesë që përdoret prej subjektit të rivlerësimit si shtëpi banimi, e mobiluar në nivel të kushtueshëm, është një pasuri e tij e fshehur nën emrin e biznesmenëve të shoqërive minerare, të cilët kishin shpërblyer subjektin me këtë pasuri për shërbimet që ai u ka kryer gjatë kohës që ka qenë prokuror në Prokurorinë e Rrethit Dibër.

Në vendimin e Komisionit arsyetohet se nisur nga të dhënat e denoncimit, është kryer një analizë e thelluar për marrëdhënien e qirasë që subjekti ka lidhur për këtë apartament në datën 1 shkurt 2017, me shtetasin A. Sh., nga e cila ka rezultuar se:

- i. nuk ka të dhëna dhe dokumentacion lidhur me pronësinë e këtij apartamenti;
 - ii. nuk provohet legjitimiteti i palës qiradhënëse, pasi edhe nëse do të merrej e mirëqenë kontrata e kleringut, ky apartament do të përfitohej nga shoqëria “{***}” ShPK, e cila referuar ekstraktit historik të regjistrit tregtar, aktualisht ka 3 aksionerë;
 - iii. nuk ka procesverbal dorëzimi të këtij apartamenti nga shoqëria ndërtuese te shoqëria “{***}” ShPK apo te shtetasi A. Sh.;
 - iv. në kontratën e sipërmarrjes nuk përcaktohet vendndodhja e këtij apartamenti;
 - v. shoqëria “{***}” ShPK nuk ka kryer faturime të mjaftueshme për të përfituar një apartament me sipërfaqe 140 m², i barasvlershëm me 140.000 euro (referuar çmimit të përcaktuar në kontratën e sipërmarrjes);
 - vi. vlera e qirasë është dukshëm më e ulët se vlera e tregut për këtë zonë;
 - vii. duket i çuditshëm fakti se pse shtetasi A. Sh. ka investuar rreth 30.000 euro për arredimin e këtij apartamenti, ndërkohë që ky send nuk gëzohet nga ana e tij apo e familjarëve të tij, si edhe nuk ka asnjë dokumentacion lidhur me pronësinë e tij.
89. Në vendimin e Komisionit është konkluduar se nisur nga indiciet e mësipërme, është çmuar se kjo pasuri është pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit, duke qenë se ai është poseduesi dhe zotëruesi i këtij apartamenti.
90. Subjekti i rivlerësimit e ka kundërshtuar këtë qëndrim të Komisionit, për të cilin ai është njoftuar me marrjen dijeni të rezultateve të hetimit paraprak dhe kalimit të barrës së provës për të provuar të kundërtën e këtij konkluzioni, në zbatim të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016. Për të provuar të kundërtën, subjekti ka paraqitur në Komision një sërë provash, si: i) deklaratë noteriale e nënshkruar ndërmjet tij dhe z. A. Sh., me nr. {***} rep. dhe nr. {***} kol., e datës 29.03.2017, nëpërmjet së cilës përcaktohet përdorimi prej subjektit i këtij apartamenti dhe vlera që do të paguhet për këtë qëllim; ii) librezë e CEZ Shpërndarje ShA, me nr. kontrate {***}, e cila figuron në emër të kompanisë “{***}” ShPK; iii) librezë e Ujësjellës-Kanalizime ShA Tiranë, me nr. kontrate 421206, në emër të shtetasit A. Sh.. Me anë të këtyre provave, subjekti ka synuar të provojë faktin se pronar i kësaj shtëpie në të cilën ai banon për shkak të kontratës së qirasë, është shtetasi A. Sh., i cili ka fituar pronësinë mbi këtë pasuri për shkak të një marrëdhënieje kleringu në tetor 2009, që shoqëria “{***}” ShPK, në të cilën ky shtetas është një nga tre bashkortakët, me shoqërinë “{***}” ShPK. Sipas kësaj marrëveshjeje, shoqëria “{***}” ShPK, ndërtuese dhe investitore ku ndodhet edhe banesa objekt hetimi, do t’i jepte në pronësi shoqërisë “{***}” ShPK një apartament dhe garazh, me vlerë respektivisht 140 mijë euro dhe 20 mijë euro, në këmbim të punimeve në duralumin që shoqëria “{***}” ShPK do të kryente për llogari të shoqërisë “{***}” ShPK. Sipas kësaj marrëveshjeje, ky apartament në këtë vlerë do të përfaqësonte vlerën e shërbimeve/punimeve që shoqëria do të kryente, e cila do të provohej se është kryer nëpërmjet faturimeve të vetë shoqërisë “{***}” ShPK për llogari të shoqërisë “{***}” ShPK.

91. Kolegji shqyrtoi këtë shkak të ankimit që lidhet me konkluzionin e mësipërm të Komisionit dhe çmoi se para tij shtroreshin për analizë dhe vlerësim disa nënçështje lidhur me këtë shkak, si më poshtë.

Së pari, nëse subjekti i rivlerësimit, në zbatim të detyrimit kushtetues për të provuar të kundërtën e konkluzioneve të Komisionit, e kishte provuar faktin e pretenduar prej tij se shtetasi A. Sh. është pronari i vërtetë i kësaj pasurie. Duke analizuar aktet shkresore që lidhen me këtë çështje, Kolegji konstaton se aktet e administruara në hetim nuk provojnë faktin e pretenduar prej subjektit. Ato përfaqësojnë elemente të copëzuara të një marrëdhënieje mes shoqërisë “{***}” ShPK dhe shoqërisë “{***}” ShPK në tregun e punës dhe shërbimeve ku operojnë këto dy shoqëri, por në asnjë rast këto akte nuk përfaqësojnë dhe japin të dhëna të drejtpërdrejta për faktin se shtetasi A. Sh. ka fituar pronësinë mbi këtë pasuri. Marrëveshja bazë që flet për marrëdhënien mes këtyre shoqërive, është ajo që daton në tetor 2009, pa u përcaktuar data. Kolegji konstaton fillimisht inkonsistencë fizike në këtë dokument, i cili nis si një marrëveshje private mes palëve dhe, nga përmbajtja e tij, duket se përfundon si një marrëveshje para noterit publik, por në fakt në ekstremitet të aktit nuk pasqyrohet prezenca e asnjë noteri publik që të ketë konfirmuar/redaktuar apo nënshkruar këtë akt, i cili mbyllet i nënshkruar vetëm nga palët. Vetë dispozitat e këtij dokumenti janë të paqarta në drejtim të të drejtave dhe detyrimeve që lindin për palët, në drejtim të shërbimit që merret përsipër të kryhet nga shoqëria “{***}” ShPK dhe mënyrës së shpërblimit të këtij shërbimi prej shoqërisë “{***}” ShPK, në të nuk përcaktohen as modalitetet për ekzekutimin e detyrimeve që burojnë prej saj. E gjithë kjo panoramë krijon në vlerësimin e Kolegjit premisa për derivate të paqarta ligjore që do të burojnë prej kësaj marrëveshjeje, të cilën subjekti e konsideron si aktin juridik që i ka dhënë të drejtën e pronësinë shtetasit A. Sh..

92. Duke vijuar më tej, në referim e interpretim të përmbajtjes së këtij akti, shoqërisë “{***}” ShPK i lindi e drejta të përfitonte një apartament në vlerën 140 mijë euro prej shoqërisë “{***}” ShPK, në varësi e për llogari të faturimeve që shoqëria “{***}” ShPK do të bënte për llogari të shoqërisë “{***}” ShPK për punët e shërbimet që do kryheshin në favor të saj. Duket se marrëveshja mes palëve ishte e tillë, që në këmbim të një pune e shërbimi që do të kishte një vlerë të njëjtë më vlerën 160 mijë euro (shtëpi + garazh) që do të faturuhej e dokumentohej nëpërmjet faturave tatimore të shitjes, shoqëria do të merrte si kundërvlerë apartamentin dhe garazhin e dakordësuar. Nga hetimi administrativ ka rezultuar se vlera totale e faturave tatimore të shitjes nga shoqëria “{***}” ShPK te shoqëria “{***}” ShPK arrin vlerën 3.500.000 lekë²⁰. Në këtë këndvështrim, Kolegji konstaton se nuk provohet të jetë përmbushur kushti kryesor i aktmarrëveshjes, nga i cili do të buronin të drejtat e pretenduara të shoqërisë “{***}” ShPK, në lidhje me fitimin e pronësisë mbi një apartament dhe garazh.

Gjithashtu, nuk rezulton të jetë përpiluar asnjë dokumentacion që provon marrjen në dorëzim apo dakordësinë e palëve, dy shoqërive, për kalimin e këtij kapitali nga njëra palë te tjetra. Me zhvillimin e aktivitetit tregtar e rritjen e gamës së veprimeve juridike në qarkullimin civil, si edhe në kuadër të të gjitha përpjekjeve për të shmangur informalitetin në vend, natyrshëm janë rritur edhe pritshmëritë e kujdesi i palëve për të dokumentuar çdo marrëdhënie që ato realizojnë në kuadër të aktivitetit të tyre tregtar. Në këtë kuptim, mosekzistenca e një dokumentacioni të tillë, në të cilin palët shprehin qartazi e hapur vullnetet e tyre të përbashkëta për të hequr dorë nga disa të drejta e për të fituar disa të tjera, konsiderohet nga Kolegji jo si një neglizhencë apo mënyrë të sjelli me

²⁰ Kjo e konfirmuar nga praktika e përcjellë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, me shkresën nr. {***} prot., datë 12.04.2018.

mungesë përgjegjshmërie, por si një element që provon në vetvete mosqenien e një marrëveshjeje apo vullneti të tillë.

93. Po ashtu, në të njëjtën linjë, nuk rezulton asnjë akt shkresor, i cili do të kishte përcaktuar, në versionin se provohej që shoqëria “{***}” ShPK kishte fituar pronësinë mbi këtë apartament, sipas të cilit vetë shoqëria e cila do të ishte përfituese do ia kishte kaluar këtë pasuri në pronësi shtetasit A. Sh., si një prej ortakëve të shoqërisë. Pavarësisht marrëdhënies të posaçme që ekziston mes ortakëve të kësaj shoqërie, duke qenë se ata janë vëllezër, rregullat e tregut dhe aktivitetit të një shoqërie tregtare, të parashikuara qoftë në ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, e që rregullojnë të drejtat e ortakëve në raport me shoqërinë e pasuritë e saj apo edhe dispozitat e Kodit Civil që rregullojnë marrëdhënien e pronësisë të çdo personi fizik apo juridik me pasuritë e paluajtshme, do të duhej të ishin zbatuar për të konfirmuar e provuar të drejtat e fituara të çdo individit mbi një pasuri të tillë. Përpjekjet e subjektit për të provuar këtë marrëdhënie të shtetasit A. Sh. mbi këtë pasuri, konsiderohen nga Kolegji të dështuara, sepse asnjë dokument shkresor i përcjellë prej tij në këtë drejtim nuk provon të drejtat e pronësisë mbi këtë pasuri të këtij shtetasi. E gjithë panorama e mësipërme e çon Kolegjin në konkluzionin e njëjtë me Komisionin, se subjekti nuk arriti të provojë që të drejtat e pronësisë së kësaj pasurie i përkasin shtetasit A. Sh., si një nga pretendimet themelor i tij në drejtim të kundërshtimeve të paraqitura.
94. *Së dyti*, Kolegji mori në shqyrtim edhe pretendimin tjetër të subjektit, sipas të cilit ai e mban atë pasuri nëpërmjet një kontrate qiraje me shtetasin A. Sh. dhe se i gjithë mobilimi i kushtueshëm është kryer prej vetë atij shtetasi, për t’i shërbyer vajzës së tij, por se aktualisht shfrytëzohet e gëzohet prej subjektit, për shkak edhe të ekzistencës së disa rrethanave miqësore mes tij dhe kunatit të shtetasit A. Sh..
95. Në drejtim të këtij elementi, Kolegji pranon se në analizë të të gjitha të dhënave që rezultojnë nga hetimi, mobilimi i kësaj pasurie, apartament, duket të jetë i spikatur, aq sa vlera e tij është bërë objekt denoncimi prej denoncuesit dhe objekt shpjegimesh nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe vetë shtetasi Sh.. Në të njëjtën linjë arsyetimi, përfshihet edhe vlera e qirasë prej 30000 lekësh e një apartamenti të tillë, që presupozohet të ketë një vlerë shumë të madhe në treg, konsideruar pozicionin, sipërfaqen dhe mobilimin e tij. Nga parashtrimet shtesë të paraqitura në Kolegj prej vetë subjektit²¹, rezulton se ai e ka zgjatur kohëzgjatjen e kësaj kontrate qiraje deri në vitin 2021, pavarësisht deklarimeve të tij në seancën dëgjimore se ai do e ndërpriste menjëherë këtë marrëdhënie që dukej se po i shkatërronte karrierën profesionale²². Në vlerësimin e Kolegjit, këto fakte tregojnë më shumë për një marrëdhënie të konsoliduar e të sigurt të vetë subjektit të rivlerësimit me këtë pronë, që del jashtë kufijve normalë, logjikë e juridikë të shfrytëzimit të një marrëdhënieje qiraje. Gëzimi i gjithë frutave të një pasurie në raport të shproporcionuar me atë që duhet të ofrojë vetë marrëdhënia ligjore në bazë të së cilës mbahet sendi, të krijojnë mosbesim mbi vetë natyrën e marrëdhënies.

²¹ Subjekti i rivlerësimit Ramadan Troci, me shkresën “Parashtrime para Kolegjit”, të protokolluar me nr. {***} prot., datë 08.10.2019, ka paraqitur një deklaratë noteriale, të lidhur midis tij dhe z. Agron Sharku, e datës 01.02.2019, me nr. {***} rep., e nr. {***} kol., e hartuar nga notere M. Sh., tek e cila specifikohet se afati i qëndrimit të subjektit të rivlerësimit dhe familjes së tij në apartamentin me sip. 140 m², tek {***}, do të jetë deri më 01.02.2021, kundrejt pagesës prej 30.000 lekësh në muaj, dhe se ky apartament është i mobiluar.

²² Referuar procesverbalit të mbajtur nga Komisioni gjatë seancës dëgjimore publike të zhvilluar, rezulton që subjekti i rivlerësimit të jetë shprehur: “Kam një kontratë deri në 29.01.2019 në mos gaboj, falë Zotit do mbaroj shpejt dhe do të rikthehem në shtëpinë time dhe ta heqim kësaj belaje që më gjeti për një bisedë tre minuta në një kafe dhe kam pranuar për këtë qëllim, nuk ka pasur asnjë motiv tjetër. Unë nuk kam banesë te {***}, do ishte ëndërr, por nuk e kam”.

Sjellja e subjektit të rivlerësimit, në këtë rast duket se shkon në të njëjtën linjë dhe mënyrë me sjelljen e tij në raport me automjetin “Volkswagen Tiguan”, për të cilin gjithashtu Kolegji arriti në bindjen se është pasuri e fshehur e tij. Pavarësisht se janë elemente dhe rrethana që i përkasin pasurive të ndryshme, siç janë: i) marrëdhënia me një pronë e cila nuk deklarohet; ii) zgjedhja e një pasurie të spikatur, qoftë automjeti, qoftë apartamenti; iii) përdorimi dhe gëzimi i pasurive që sipas vetë deklarimeve të subjektit nuk i përkasin dhe nuk përfaqësojnë standardin e tij të jetesës²³; iv) përdorimi i këtyre pasurive, të cilat formalisht pretendohet se figurojnë në emër të personave që nuk arrijnë të provojnë pronësinë e tyre të ligjshme mbi këto prona; v) gëzimi dhe përdorimi i tyre jo prej pronarëve të pretenduar, por prej subjektit në një raport të zhdrejtë për sa i përket asaj që subjekti ofron në këmbim të këtyre privilegjeve, janë rrethana në vlerësimin e Kolegjit që tregojnë dhe demonstrojnë sjelljen si pronar të subjektit të rivlerësimit mbi këto pasuri.

96. Në përfundim të kësaj analize, Kolegji çmon se konkluzioni i Komisionit që pasuria apartament, e ndodhur pranë ATSh-së është një pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit, është një konkluzion i bazuar dhe se subjekti gjendet në lidhje me këtë pasuri në situatën e parashikuar prej nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016.

III. Shkaqe të ankimit që lidhen me vlerësimin e aftësive profesionale

97. Në ankimin e tij, subjekti i rivlerësimit kundërshton qëndrimin e mbajtur nga Komisioni për kontrollin e aftësive profesionale, duke prapësuar se në çështjet e analizuara që kanë të bëjnë me shkeljen e rregullave të mbrojtjes në punë, vendimet e mosfillimit të procedimeve penale për to janë të konfirmuara nga eprorët dhe se këto vendime kanë qenë objekt kontrolli nga Prokuroria e Përgjithshme, e cila nuk ka dhënë asnjë masë disiplinore për subjektin e rivlerësimit. Gjithashtu në ankim, subjekti parashtron se nga Komisioni në hetimin e kryer, nuk u gjet asnjë rast/çështje, hetimi i të cilit të ketë pasur zvarritje, të cilat, sipas kërkesave të GjEDNj-së, e bëjnë joefektiv, dhe se ai ka respektuar zbatimin e rregullave procedurale në hetimet e kryera, ndërkohë që e gjithë problematika e ngritur prej Komisionit ka qenë e evidentuar prej denoncuesve anonimë.
98. Referuar përmbajtjes së vendimit të Komisionit, rezulton se për kontrollin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, përtej kontrollit të ushtruar mbi çështjet e përzgjedhura në zbatim të nenit 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, është kryer kontroll mbi veprimtarinë e zhvilluar prej tij në rrethet ku ka ushtruar detyrën e prokurorit, përkatësisht në Vlorë dhe Dibër, për të cilën në Komision ka pasur denoncime nga publiku, në zbatim të nenit 43, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Konkluzionet e Komisionit mbi kontrollin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit Ramadan Troci rezultojnë të jenë bazuar në kontrollin e 7 (shtatë) dosjeve që lidhen me veprimtarinë procedurale të tij si prokuror në këto çështje, të gjitha të regjistruara për ushtrimin e ndjekjes penale për veprimtari kriminale të shkeljes së rregullave të mbrojtjes në punë, që ka passjellë dëmtimin e shëndetit apo humbjen e jetës së shtetasve, të parashikuar nga neni 289 i Kodit Penal. Ky aktivitet procedural është zhvilluar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Bulqizë dhe në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Dibër, pasi ngjarjet kriminale kanë ndodhur në galeritë minerare të Bulqizës, territor në të cilin ushtronin kompetencat këto dy prokurori.

²³ Sjellim në vëmendje se në shpjegimet e dhëna nga subjekti gjatë hetimit, por edhe në ankim, lidhur me arsyet e përdorimit të automjetit “Volkswagen Tiguan” të vëllait të tij për daljet jashtë vendit, është shpjeguar se kjo ka ndodhur për shkak të pamundësisë për blerjen e siguracionit ndërkombëtar që kushton rreth 400 euro dhe kjo e lidhur me nivelin racional të jetesës së tij.

99. Nga shqyrtimi i akteve të fashikullit të gjykimit, të cilat janë marrë në analizë nga Komisioni, dhe pasqyrimin të të gjitha shkeljeve të prezantuara në vendim, është arritur në përfundimin se: *Subjekti i rivlerësimit përbën një model pune aq të dobët, saqë rrezikon ose shkel të drejtat e qytetarëve. Me këtë model pune, prokurori dështon së kryeri detyrën e tij për të respektuar, mbrojtur dhe mbështetur dinjitetin njerëzor dhe të drejtat e njeriut. Prandaj, nisur nga konkluzionet e nxjerra nga analizimi i dosjeve të mësipërme, Komisioni çmon se pozita e subjektit duhet të konsiderohet në vështrim të nenit E, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i cili thotë: “5. Në rast se subjekti i rivlerësimit kryen veprime për të penguar ose vështirësuar vlerësimin e tij, ose rezulton se ka njohuri, aftësi, gjykim, qëndrime, ose një model pune aq të dobët saqë rrezikon ose cenon të drejtat e qytetarëve, ai konsiderohet i papërshtatshëm për të ushtruar funksionin. Në këtë rast zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën”.*

Subjekti i rivlerësimit ka ngritur në ankim pretendime të tij për këtë konkluzion të Komisionit, të cilat analizohen si më poshtë.

100. Në lidhje me pretendimin se shkeljet e analizuara që kanë të bëjnë procedimet penale të mosfilluara apo pushuara për veprën penale të parashikuar nga neni 289 i Kodit Penal, janë kontrolluar e verifikuar nga prokurorët më të lartë në Prokurorinë e Përgjithshme dhe janë konstatuar si hetime të kryera në përputhje me ligjin, Kolegji arsyeton se:

Së pari, procesi i rivlerësimit është një proces i parashikuar nga Kushtetuta e Shqipërisë, i miratuar dhe i gjithëpranuar si një proces i jashtëzakonshëm kontrolli për subjektet e rivlerësimit, i cili kryhet në funksion të përmbushjes së qëllimit të shpallur në nenin 179/b të Kushtetutës²⁴ për rikthimin e besimit të publikut te drejtësia. Qëllimi dhe objektivi i kontrollit të ushtruar përgjatë këtij procesi mbi të tria kriteret e rivlerësimit nuk janë të njëjtë me qëllimin dhe objektivin që ndjek kontrolli rutinë/periodik, apo qoftë i veçantë, që kanë kryer strukturat kontrolluese brenda sistemit të drejtësisë, në zbatim të kuadrit ligjor të përgjithshëm në fuqi.

Asnjë parashikim kushtetues apo ligjor nuk kushtëzon ushtrimin e kontrollit prej organeve të rivlerësimit, duke marrë në konsideratë ose jo raportet apo rezultatet e kontrollit të ushtruar më parë prej strukturave përkatëse brenda organeve të sistemit të drejtësisë, madje në përputhje me interpretimin pajtues të vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, as raportet që ndërtohen nga këto institucione, në funksion të këtij procesi, nuk kushtëzojnë qëndrimin e vendimmarrjen e organeve të rivlerësimit brenda fushës së tyre të veprimit.

Në këtë arsyetim, potencialisht fakti i pretenduar për kontroll nga prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme për ushtrimin e funksioneve profesionale të subjektit, nuk pengon në kuptim të ligjit nr. 84/2016 të drejtën e organeve të rivlerësimit për të kryer kontrollin dhe vlerësimin e tyre në mënyrë të pavarur e objektive dhe sigurisht në përputhje me qëllimin e parashikuar në ligj për kryerjen e këtij procesi për verifikimin e nivelit të aftësive profesionale dhe etike të subjektit të rivlerësimit dhe përcaktimin e nivelit të këtij kriteri sipas parashikimeve të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016. Kontrolli i ushtruar prej strukturave drejtuese në Prokurorinë e Përgjithshme, i pretenduar prej subjektit, ka ndjekur qëllime të tjetra në përputhje me kompetencat dhe detyrat e këtyre strukturave, në përmbushje të një detyrimi tjetër kushtetues, atij të ushtrimit të ndjekjes penale.

²⁴ Neni 179/b, pika 1 e Kushtetutës përcakton:

“1. Sistemi i rivlerësimit ngrihet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, si edhe të rikthehet besimi i publikut tek institucionet e këtij sistemi”.

101. *Së dyti*, ky pretendim i subjektit të rivlerësimit nuk gjendet i bazuar as në situatën faktike që rezulton prej akteve të administruara në dosje. Pas shqyrtimit të këtyre akteve, rezulton se në kontrollin e ushtruar prej strukturave të Prokurorisë së Përgjithshme²⁵, të pretenduar nga subjekti, në të gjitha rastet, qoftë në kontrollet tematike apo të përgjithshme për Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Dibër, qoftë në kontrollin individual për punën e subjektit të rivlerësimit, përfshihet vetëm një nga çështjet e analizuara prej Komisionit në marrjen e këtij vendimi²⁶, ndërkohë që asnjë prej gjashtë çështjeve të tjera nuk ka qenë ndonjëherë objekt kontrolli apo verifikimi nga ky institucion.
102. Në këtë kontekst, edhe rezultatet e kontrollit të ushtruar nga Prokuroria e Përgjithshme, nuk mund të vlerësohen vetëm mbi konkluzionet e mbajtura për vetëm njëherë nga çështjet objekt shqyrtimi në këtë rast, konkluzion i cili mund të ishte i ndryshëm në rast se do të ishin analizuar të gjitha çështjet së bashku, pikërisht për shkak të ekzistencës së një tipologjie të gabuar në hetimin e rasteve, tipologji e cila ndryshe nga rasti i vetëm, të çon në konkluzionet që ka arritur Komisioni. Në lidhje me pretendimin se vendimet e subjektit të rivlerësimit kanë qenë objekt kontrolli e verifikimi nga eprorët, në zbatim të dispozitave procedurale penale e urdhrave të Prokurorit të Përgjithshëm, për pasojë përgjegjësia për vendimet e tij nuk i përket subjektit, Kolegji çmon se është një pretendim i pabazuar në dispozita ligjore dhe, për më tepër, në shmangie të përgjegjësive që një prokuror duhet të ketë në ushtrimin e funksioneve të tij.
103. Për shkak të parashikimeve kushtetuese ligjore të kohës në të cilën janë marrë vendimet objekt shqyrtimi dhe funksionimit të prokurorisë si një organ i centralizuar, Kolegji vlerëson se kuadri ligjor në fuqi garantonte pavarësinë e prokurorit të çështjes në vendimmarrjen e tij, për pasojë ishte në gjendje të evidentonte edhe përgjegjësinë e tij në rastet e shkeljes së ligjit. Dispozitat ligjore, neni 25 i Kodit të Procedurës Penale²⁷ apo urdhrin nr. 147, datë 09.05.2008²⁸, të Prokurorit të Përgjithshëm rregullojnë mënyrën e kontrollit dhe marrjes së vendimeve nga prokurorët më të lartë, me qëllim unifikimin e mënyrës së ushtrimit të funksioneve në prokurori, por nuk parashikojnë zhveshjen nga përgjegjësia të prokurorëve të çështjes në marrjen e vendimeve prej tyre, përkundrazi saktësojnë pikërisht ndarjen e përgjegjësive dhe përcaktojnë mjetet ligjore për të siguruar pavarësinë e prokurorit të çështjes në vendimmarrje prej autoritetit të drejtuesit të prokurorisë, si prokuror më i lartë.

Edhe në këtë kuptim, pretendimi i subjektit se ai nuk përgjigjet për vendimmarrjet e tij sepse kjo përgjegjësi i takon drejtuesit të prokurorisë, mbetet një pretendim i pabazuar.

²⁵ *Shkresa e Drejtorisë së Kontrollit të Hetimit të Prokurorisë së Përgjithshme nr. {***} prot., datë 07.05.2009.*

²⁶ *Referuar raportit të datës 28.10.2009 të Drejtorisë së Kontrollit të Hetimit dhe Ndjekjes Penale në Prokurorinë e Përgjithshme, rezulton të jetë kontrolluar vetëm çështja për referimin penal nr. {***}, e vitit 2007, ku ka gjetur vdekjen shtetasi S. D. dhe jo çështjet e tjera të dhëna në vendimin e Komisionit nr. 77, datë 15.11.2018*

²⁷ *Neni 25 i Kodit të Procedurës Penale parashikon:*

Ushtrimi i funksioneve të prokurorit

(Ndryshuar pika 2 dhe 3 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Funksionet e prokurorit ushtrohen: a) në hetimet paraprake dhe në gjykimet e shkallës së parë, nga prokurorët pranë gjykatave të shkallës së parë; b) në gjykimet e çështjeve të ankimuar, nga prokurorët pranë gjykatave të apelit dhe pranë Gjykatës së Lartë.

2. Në ushtrimin e funksioneve të tij, prokurori është i pavarur. Rregullat për mënyrën e ushtrimit të funksioneve nga prokurori parashikohen në ligj.

3. Për veprat penale të parashikuara nga neni 75/a i këtij kodi, funksionet, sipas nenit 24 të tij, ushtrohen në të gjitha shkallët e gjykimet nga prokurorët e Prokurorisë së Posaçme.

²⁸ *Në pikën 6 të urdhrin nr. 147, datë 09.05.2008, të Prokurorit të Përgjithshëm përcaktohet:*

“Prokurori mund të bëjë ankim tek Prokurori i Përgjithshëm, në rastet kur nuk është dakord me qëndrimin e drejtuesit të Prokurorisë ose të prokurorit më të lartë.

104. Në lidhje me pretendimin e subjektit se nga analiza e këtyre çështjeve nuk u konstatua asnjë rast në të cilin të kishite zvarritje të hetimeve që bie ndesh me kërkesat e GjEDNj-së për një gjykim të shpejtë, Kolegji çmon se ngritja e këtij pretendimi duket se nuk ka relevancë në konkluzionet e Komisionit.

Në arsyetimin e shkeljeve të konstatuara prej Komisionit, nuk gjendet një konkluzion i tillë që do të bënte të arsyeshëm pretendimin e subjektit të rivlerësimit. Përkundrazi, Komisioni ka konkluduar se ai përgjithësisht shoqërohet nga problematika e moshetimit të thelluar për zbulimin e së vërtetës, rrethanë që të çon në përdorimin e një afati të shkurtër kohor për marrjen e vendimeve. Pavarësisht kësaj rrethane, Komisioni me të drejtë ka arsyetuar se mungesa e hetimit dhe moskryerja e veprimeve procedurale të nevojshme ka penguar zbulimin e së vërtetës dhe ka cenuar zbatimin e garancive të Konventës Evropiane për mbrojtjen e Lirive e të Drejtave Themelore të Njeriut, sepse është e pamundur të garantohej parimi thelbësor dhe bazik i kësaj konvente, e drejta për jetën, parashikuar nga neni 2 i saj. Duke mos ushtruar në mënyrën e duhur ndjekjen penale, madje në të shumtën e rasteve duke mos e ushtruar krejtësisht atë, Komisioni me të drejtë ka vlerësuar se subjekti ka cenuar të drejtën e qytetarëve për jetën e shëndetin. Në vlerësimin e Kolegjit, kërkesat e jurisprudencës së GjEDNj-së për gjykim efektiv, nuk mund të shkelin garancitë për trajtim të drejtë e në përputhje me të gjitha parimet e tjera të një procesi të rregullt. Detyra e funksionarëve publikë në këtë këndvështrim është realizimi i një procesi në të cilin të garantohen në mënyrë proporcionale e të ekuilibruar të gjitha parimet e parashikuara në konventë, duke përcaktuar saktë ato parime që prevalojnë në raport me të tjerat.

Për pasojë, edhe ky pretendim i subjektit gjendet i pabazuar.

105. Në lidhje me pretendimin e parashikuar nga subjekti se ekspertët e caktuar në çështjet penale të analizuara, janë të përzgjedhur sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale, për pasojë konkluzionet e Komisionit në këtë rast janë të padrejta, Kolegji çmon se ky pretendim duhet të vlerësohet në raport me të gjithë problematikën e konstatuar dhe jo si një problem sporadik.

Nga analiza e çështjeve, Komisioni ka konstatuar se subjekti ka caktuar të njëjtët ekspertë në këto çështje dhe, pavarësisht problemeve që rezultojnë në lidhje me zbatimin e normave procedurale, të karakterit formal, problematika e evidentuar lidhet kryesisht me faktin që subjekti i ka dhënë në mënyrë të paracaktuar një vlerë absolute aktit të ekspertimit të kryer prej tyre, pa tentuar të thellojë hetimet e të përcaktojë vlerën e aktit të ekspertimit, krahasuar edhe me fakte të tjera të dala nga hetimi. Duket se e gjithë qasja e subjektit në hetimin e këtyre çështjeve përfaqësohej nga një veprim i vetëm procedural, që është caktimi i eksperti teknik dhe marrja e aktit të realizuar prej tij.

Kjo rrethanë e parë, lidhur me rrethanat e tjera, që përgjithësisht janë të njëjtët ekspertë, për të cilët në dosje nuk figurojnë të dokumentuara të dhënat që legjitimojnë qenien e tyre si të tillë, në çdo rast me një analizë sipërfaqësore të fakteve, të cilat kanë rezultuar vetëm nga veprimet e para hetimore dhe nuk janë pasuruar me të dhëna të tjera të dala nga hetimi, arrijnë në konkluzione gjithmonë të njëjta, duke përcaktuar si shkelës të rregullave viktimën, e cila nuk mund të përgjigjet penalisht, dhe gatishmëria e subjektit që këto konkluzione të nxjerra nga individë që formalisht nuk janë përzgjedhur në përputhje me kërkesat e ligjit dhe të mbështetura mbi një bazë të kufizuar të dhënash, e kanë çuar me të drejtë Komisionin të konstatojë problematikën me përzgjedhjen e caktimit të ekspertëve, si një çështje që ka ndikuar në vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit.

106. Në lidhje me pretendimin se kontrolli dhe vlerësimi i aftësive profesionale të subjektit është bërë vetëm nisur nga çështje për të cilat ka pasur ankime apo denoncime anonime dhe pa shfrytëzuar burimet e parashikuara nga ligji për këtë vlerësim, Kolegji çmon se mbetet një pretendim i cili përveç se është i pabazuar, nuk prek dhe nuk cenon konkluzionin e Komisionit në lidhje me vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

Nga shqyrtimi i akteve të administruara, rezulton se Komisioni ka verifikuar e vlerësuar të gjitha çështjet të cilat janë dorëzuar nga subjekti dhe janë përzgjedhur me anë të shortit, në zbatim të nenit 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

Përtej këtij vlerësimi, Komisioni ka verifikuar edhe ankesat e denoncimet e qytetarëve adresuar aspektit profesional të subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 43, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

Kjo bazë e gjerë materiale mbi të cilën Komisioni ka ndërmarrë veprimtarinë e tij vlerësuese, është në të kundërtën e asaj që pretendon subjekti, një mundësi shumë e mirë për të kuptuar thellësisht nivelin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit. Për më tepër, pavarësisht rezultateve të cilat mund të kishin dalë nga kontrolli i çështjeve të pretenduara nga subjekti, do të mbetej e qartë dhe prezente problematika e konstatuar nga analizimi i çështjeve objekt i këtij gjykimi, dhe çfarëdo rezultati tjetër në vlerësimin e Kolegjit nuk do të ndikonte apo çbënte konkluzionin e nxjerrë nga Komisioni, në lidhje me shkeljet e konstatuara tashmë.

Në çfarëdo shtate të pasuruar me të dhëna të tjera, Kolegji çmon se niveli i aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit nuk do të mund të ngrihej mbi atë të përcaktuar nga Komisioni, në zbatim të nenit 44, germa “c” e ligjit nr. 84/2016.

107. Në konkluzion të analizës për shkaqet e ankimit që lidhen me konkluzionin për kontrollin e kriterit të aftësisë profesionale, Kolegji çmon se qëndrimi i Komisionit për këtë çështje është i drejtë dhe i mirëpërcaktuar, në përputhje me parashikimet e nenit 44, germa “c” dhe nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

IV. Lidhur me cenimin e besimit të publikut

108. Në lidhje me shkakun e ankimit që i adresohet konkluzionit të Komisionit, sipas të cilit subjekti ka shkelur besimin e publikut të drejtësia, ai ka pretenduar se dhe aplikimi i kriterit të cenimit të besimit të publikut është i pabazuar, pasi në asnjë rast Komisioni nuk arriti të provojë se ai ka pasuri më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme, ka probleme me figurën, apo ka fshehur pasuri, apo ka bërë deklaram të pasaktë të tyre, si dhe nuk rezulton i papërshtatshëm nga vlerësimi i aftësive profesionale.
109. Nga analizimi i vendimit të Komisionit, rezulton se ai ka arritur në këtë konkluzion duke arsyetuar se: *Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konkludon se subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, rezulton i papërshtatshëm nga vlerësimi i aftësive profesionale, si edhe nga vlerësimi tërësor, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, rezulton se subjekti ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit.*

110. Kolegji, duke shqyrtuar pretendimet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me këtë konkluzion të Komisionit, ndonëse nuk konstaton në arsyetimin e vendimit arsye specifike, të cilat e kanë çuar Komisionin në këtë konkluzion, në të njëjtën mënyrë vlerëson edhe pretendimin e subjektit për kundërshtimin e këtij konkluzioni si të papërcaktuar, por të shtruar në terma e pretendime të përgjithshme. Pavarësisht këtyre rrethanave, Kolegji çmon se në thelb, qëndrimi i Komisionit edhe për këtë konkluzion është i drejtë.
111. Në vlerësimin e Kolegjit, duke vlerësuar në tërësi të tria kriteret e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, në kuptim të nenit 4, paragrafi 2 i ligjit nr. 84/2016, rezultojnë disa rrethana të cilat të analizuara së bashku e të para në raport me njëra-tjetrën tregojnë për një sjellje e raport të subjektit të rivlerësimit me detyrën, e cila do të ishte e papranueshme për të pasur besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe te roli i subjektit, si një funksionar i denjë i atij sistemi. Në këto rrethana përfshihen si problematika e konstatuar në drejtim të kontrollit të kriterit të pasurisë, në lidhje me konstatimet për pasuritë e fshehura të subjektit dhe përdorimit të tyre drejt realizimit të një standardi jetese që nuk përputhet me nivelin e pëlqyeshëm që do i takonte një funksionari publik në sytë e publikut. Në vlerësimin e Kolegjit, jo vetëm përfitimi në mënyrë të padrejtë i pasurive, por edhe ekspozimi me arrogancë i marrëdhënies me to, siç është jetesa në një banesë apo përdorimi i një automjeti që shkojnë përtej mundësive financiare të ligjshme e të pritshme të tij, është një fakt që prek dhe cenon besimin e publikut te sistemi i drejtësisë. Pjesë e kësaj arrogance që konceptohet se vjen nga pushteti, në sytë e publikut është edhe pasurimi dukshëm i familjarëve të tij, qoftë nëpërmjet shkeljeve të ligjit të pranuar nga subjekti në rastin e vëllait të tij²⁹, qoftë nëpërmjet përfitimeve të dyshuara si një trafik i mundshëm interesi në rastin e kumatit të tij dhe aktivitetit të tij në fushën e shfrytëzimit të minierave³⁰. Trajtimi i këtyre të dhënave merr relevancë në rastin konkret pikërisht për shkak të përfitimeve të pashpjegueshme në masa të larta dhe mënyrës e faktit se si subjekti i rivlerësimit i ka parashtruar ato, si edhe për faktin se ato kanë ndodhur e janë realizuar gjatë kohës që subjekti ushtronte funksionin e prokurorit.
112. Gjithashtu, në vlerësimin e Kolegjit, sjellja e subjektit në drejtim të trajtimit të çështjeve penale që lidhen me hetimin e veprave penale të shkeljes së rregullave të mbrojtjes në punë, të cilat kanë sjellë si pasojë humbjen e jetës së qytetarëve, me një neglizhencë të dukshme e me një qasje gati të paracaktuar drejt përcaktimit të përgjegjësisë te viktimat e aksidentit, do të lexohej nga publiku si një sjelle që nuk ngjallte besim te sistemi i drejtësisë, përderisa në të gjitha këto raste subjekti i rivlerësimit ka vendosur të ndëshkojë të dëmtuarit dhe ka shmangur nga hetimi dhe përgjegjësia

²⁹ Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet e dhëna prej tij për rezultatet paraprake të hetimit, ka shpjeguar se ai nuk ka lidhje me pasuritë e vëllait të tij në pallatin “{***}”{***}, dhe se i ka kërkuar informacion të vëllait mbi pasuritë që ka dhe të ardhurat për blerjen e tyre dhe se vëllai i tij, z. N. T., me anë të një deklaratë noteriale ka shpjeguar në detaje çdo të ardhur të siguar prej tij, duke vënë në dispozicion edhe dokumentacionin që provon pasuritë e tij, si dhe arsyet e mosdeklarimeve reale pranë zyrës së tatimeve .

³⁰ Fitimet e kompanisë “{***}” ShPK janë të evidentuara nga pasqyrat financiare të depozituara nga kjo kompani pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Nga këto të dhëna, rezulton se fitimi i shpërndarë për vitet 2013 ka qenë 769.997 lekë; për vitin 2014 fitimi i shpërndarë rezulton të ketë qenë 113.338 lekë; për vitin 2015 fitimi i shpërndarë ka qenë 5.667.923 lekë dhe për 2016 fitimi i shpërndarë ka qenë 4.924.992 lekë. Gjatë kësaj periudhe, përveç fitimit të shpërndarë, kompania ka shlyer gjithashtu edhe detyrimin ndaj ortakëve, në masën 11.150.572 lekë, si dhe ka rritur aktivitetin e saj në masën 264% në krahasim me vitin e parë të veprimtarisë së saj. Nga analizimi i këtyre pasqyrave financiare, rezulton se ka një rritje të aktivitetit të shoqërisë për vitet 2011-2016, e shoqëruar kjo me fitime të siguruara dhe të shpërndara tek aksionerët, si dhe me rritje të aftësisë paguese dhe shlyerje të detyrimeve ndaj ortakëve. Të gjitha këto të dhëna mbi aktivitetin tregtar të kësaj kompanie bëjnë të konsiderohet si transaksion i pajustificuar në aspektin financiar (sipas logjikës ekonomike e rregullave të tregut), dhurimi i aksioneve nga kunati i subjektit të rivlerësimit, z. R. M., në vitin 2016.

një kategori shumë të mundshme për të qenë e tillë, siç janë kompanitë që shfrytëzojnë burimet minerare³¹.

113. Në vlerësimin e Kolegjit, këto rrethana të cituara më lart, do të përbënin mjaftueshëm një bazë të dhënash mbi të cilën mund të konkludohej se subjekti ka shkelur besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, edhe sikur të mos ekzistonin rrethanat që kanë bërë të mundur aplikimin e nenit 61, pikat 3 e 4 të ligjit nr. 84/2016, duke bërë të zbatueshëm në mënyrë autonome paragrafin 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, si një prej shkaqeve të shkarkimit nga detyra të subjektit.
114. Në përfundim të shqyrtimit të ankimit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit Ramadan Troci ndaj vendimit të Komisionit nr. 77, datë 15.11.2018, Kolegji pasi ka shqyrtuar të gjitha shkaqet e ankimit të parashtruara më sipër, çmon se shkeljet e konstatuara lidhur me kriterin e kontrollit të pasurisë e të aftësive profesionale plotësojnë kushtet e shkeljes së ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 61, pikat 3 e 4, gjithashtu edhe në kuadër të vlerësimit tërësor e klasifikojnë subjektin e rivlerësimit në kushtet e parashikuara nga neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, e cila përcakton si sanksion shkarkimin e subjektit të rivlerësimit nga detyra.
115. Kolegji e mbështet këtë konkluzion në përfundimet e mëposhtme, sipas të cilave vendimi nr. 77, datë 15.11.2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është i drejtë në disponimin e tij për sa vijon:

I. Në lidhje me kriterin e kontrollit të pasurisë

a) Subjekti i rivlerësimit rezulton të ketë:

(i) mungesë të burimeve të ligjshme për kryerjen e pagesës së këstit të parë të pasurisë apartament, me vendndodhje në kompleksin “{***}”, me numër pasurie nr. {***}, rruga “{***}”, shkalla {***}, nr. {***}, {***}, Tiranë;

(ii) mungesë të burimeve të ligjshme financiare për blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz”, në vitin 2008;

(iii) mungesë të burimeve të ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin e plotë të depozitës në Bankën Credins, në fund të vitit 2016, situatë faktike që kualifikohet sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

b) Subjekti i rivlerësimit ka kryer fshehje të pasurisë, duke mos deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* marrëdhënien e tij ligjore me objektin e ndërtuar pa leje, me sipërfaqe 32 m², në truall të zënë me sipërfaqe 450 m², në {***}, Tiranë (në proces legalizimi gjatë procesit të rivlerësimit) në kundërshtim me parashikimet e nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003, “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, duke e konsideruar këtë situatë faktike që kualifikohet sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016.

c) Subjekti i rivlerësimit ka kryer fshehje të pasurisë, në lidhje me mosdeklarimin në deklaratën *vetting* të pasurisë apartament, me sipërfaqe 140 m² pranë {***}, Tiranë, për të cilën edhe Kolegji arrin në konkluzion të njëjtë, duke e konsideruar se është pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit, duke e kualifikuar këtë situatë sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016.

³¹ Për 7 (shtatë) çështjet e shqyrtuara nga Komisioni, të evidentuara në vendimin nr. 77, datë 15.11.2018, për 3 (tri) prej tyre subjekti i rivlerësimit ka vendosur mosfillimin e procedimit, ndërsa për 4 (katër) çështjet e tjera ka vendosur pushimin e procedimit penal.

ç) Subjekti i rivlerësimit ka kryer fshehje të pasurisë, në lidhje me mosdeklarimin në deklaratën *vetting* të të drejtave të tij të përdorimit e të pronësisë për automjetin tip “Volkswagen Tiguan”, viti i prodhimit 2009, i cili ka rezultuar i regjistruar në pronësi të vëllait të tij, z. N. T., duke e kualifikuar këtë situatë sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016.

Kolegji, në përfundim të kontrollit të kriterit të vlerësimit të pasurisë, duke analizuar e konsideruar në tërësi konkluzionet e mësipërme, çmon se plotësojnë kërkesat e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 dhe vendosin subjektin e rivlerësimit në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm të parashikuar nga ky nen, si një nga rastet e parashikuara për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

II. Në lidhje me kriterin e kontrollit të aftësive profesionale

Konkludohet se aktiviteti profesional i subjektit të rivlerësimit është i shoqëruar me njohuri, aftësi, gjykim, qëndrime ose një model pune aq të dobët, saqë ka rrezikuar apo cenuar të drejtat e qytetarëve, për pasojë ai konsiderohet si i papërshtatshëm për të ushtruar funksionin e prokurorit, sipas parashikimit të nenit 44, germa “c” e ligjit nr. 84/2016. Për shkak të këtij konkluzioni, Kolegji vlerëson se subjekti gjendet në kushtet e parashikuara nga neni 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, duke plotësuar në këtë mënyrë një nga rastet e parashikuara për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

III. Në lidhje me cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë

Pas vlerësimit tërësor në kuptim të nenit 4, paragrafi 2 i ligjit nr. 84/2016, të kriterit të kontrollit të pasurisë dhe të kontrollit të aftësive profesionale, konkludohet se shkeljet e ligjit nga subjekti i rivlerësimit apo problematikat e konstatuara nga vlerësimi në tërësi i kriterit pasuror, si dhe impakti që ka shkaktuar në publik sjellja dhe aktiviteti profesional i subjektit të rivlerësimit, besohet se kanë cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe, për këto shkaqe, ai duhet të konsiderohet i papërshtatshëm për vijueshmërinë e detyrës, në zbatim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016

116. Kolegji shqyrtoi dhe analizoi edhe shkaqet e tjera të ankimit të parashtruar prej subjektit të rivlerësimit, disa prej të cilave rezultuan të drejta, por u vlerësuan të pamjaftueshme për të cenuar vendimin e Komisionit objekt shqyrtimi.
117. Në përfundim, trupi gjykues, pasi analizoi të gjitha aktet e administruara gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni dhe që janë pjesë e fashikullit gjyqësor, si dhe shqyrtoi vendimin nr. 77, datë 15.11.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit mbi bazën e shkaqeve të ankimit, mbështetur në konkluzionet e mësipërme, arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Ramadan Troci ka kryer deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë në kuptim të nenit D, pikat 3 e 5 të Aneksit të Kushtetutës e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, rezulton i papërshtatshëm nga vlerësimi i kriterit të aftësive profesionale në kuptim të nenit E, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, si edhe rezulton se nëpërmjet sjelljes së tij në raport me kriterin e pasurisë e kriterin e aftësive profesionale ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, sipas parashikimit të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
118. Në këto rrethana, Kolegji, pasi e gjykoi çështjen në dhomë këshillimi, bazuar në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 49 e 55 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, çmon se vendimi nr. 77, datë 15.11.2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në lidhje me vlerësimin e kriterit të kontrollit të pasurisë,

kontrollit të aftësive profesionale, vlerësimin në tërësi të tyre sipas konkluzioneve të mësipërme, si dhe vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, është i drejtë dhe i bazuar.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 77, datë 15.11.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Ramadan Troci.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, më datë 21.10.2019.

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

ANËTAR

Luan DACI

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

RELATORE

Ina RAMA

nënshkrimi

KRYESUES

Ardian HAJDARI

nënshkrimi